



DIALOGU, PRIJËSI FETAR
DHE INDIVID I NË ISLAM



DUAJA NË JETËN
E BESIMTARIT



DR. MUSTAFA MAHMUD -
MENDIMTAR, SHKRIMTAR,
MJEK DHE LETRAR EGJIPTIAN

UDHA ISLAME

Viti 18 - Nr. 3 (205), Mars, 2020

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

TË KTHEHEMI NGA VLERAT E BESIMIT *dhe të lutemi me zemër* PËR MËSHIRË E BEKIM!

"Feja e Zotit është optimizëm e shpresë
për njeriun, jo e kundërta! Rrini të qetë
se nuk bëhet kijameti, sa të jemi ne në këtë botë!"



PO TË ISHTE YT BIR, ... DO THOJE TË VËRTETËN!



MYFTIU I DREJTOHET BESIMTARËVE
ME NJË MESAZH SHPRESE





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

(DY FJALË NË PROMOVIMIN E LIBRIT: "DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST", NGA DR. MUSTAFA MAHMUD, SJELLË NË SHQIP NGA THIRRËSI ISLAM LAVDRIM HAMJA)

Libri i ri që promovojmë sot, "Dialog me mikun tim ateist", shkruar nga studiuesi dhe intelektual i shquar egjiptian, Dr. Mustafa Mahmud, sjellë në shqip nga thirrësi islam Lavdrim Hamja, është padyshim një vlerë e shtuar për librotekat tona.

Është një libër që lexohet me kujdes, por që vlen për secilin prej nesh, sidomos në kohëra si këto, kur thuajse nga çdo drejtim dëgjojmë sulme të pandërprera ndaj Islamit dhe muslimanëve.

Aq sa janë paradoksale ato që lexojmë e dëgjojmë, aq është i domosdoshëm për t'u qarkulluar në mesin e lexuesve ky libër, që gjithsesi nuk është as fillimi, as fundi i trajtesave të të pjekura e plot urtësi të tematikave të këtij niveli, që shpesh kanë ngacmuar botën, lidhur me Islamin.

"Nuk është i lindur dhe nuk ka lindur kush prej Tij", "Nëse All-llahu m'i ka përcaktuar veprat e mia, atëherë përse më merr në llogari?", "Përse All-llahu e ka krijuar të keqen?", "Cili është gjynahu i atij që nuk i ka mbërritur Kur'ani?", "Gruaja në Islam", "A është feja opium?", "Shpirti", "Ndërgjegjja", "A janë ritet e Haxhit idhujtari?", "Përse të mos jetë Kur'ani i shkruar nga Muhammedi?!", "Qëndrimi i fesë ndaj evolucionit", "Kuptimi i fesë", etj., janë disa prej tematikave që trajton ky botim i ri, i shumëpritur në mesin tonë.

Secila prej këtyre tematikave, që autori i ka dhënë hakun, kërkon një trajtim më vete në kontekstet e një dialogu të mrekullueshëm me një mik ateist. Në pamje të parë duket si e habitshme që ai ta quajë personin

DIALOGU, PRIJËSI FETAR DHE INDIVID I NË ISLAM

përballë vetes, mik. Në të vërtetë, Dr. Mustafa Mahmud vjen vetë nga bota e ateizmit, por ajo që vlen më së shumti është se në Islam, tjetri nuk paragjykohej, kushdo qoftë e sado i devijuar a i paudhëzuar që të jetë!

Ka rëndësi të madhe të kuptohet se në Islam, "Në fillim ishte dialogu! Melekët e madhëronin dhe e shenjtëronin All-llahun në përkushtim e sinqeritet. Pastaj, don All-llahu dhe krijohet njeriu, për të qenë "mëkëmbësi i Tij në tokë". Dhe fillon dialogu nëpërmjet pyetjeve për natyrën e tij, për rolin e tij, për anë negative dhe ato pozitive të tij.

All-llahu i përgjigjet për krejt pyetjet e tyre, siç e përshkruan Kur'ani në mënyrë të përmblodhur këtë ndodhi. Dialogu mbyllet tek caku i pozitës së tyre në kufirin e njohurisë që ata zotërojnë: "Me të vërtetë, Unë di atë që ju nuk e dini!"^[1]...

Pastaj erdhën pejgamberët për t'i mësuar njeriut natyrën e fjalës, që merr dhe jep, për të mësuar se si të trajtojë me të problemet e tij, se si të zgjidhë divergjencat e tij nëpërmjet saj, sepse ajo përfaqëson dritaren, nëpërmjet së cilës njeriu vëzhgon atë që ka në brendësinë e tjetrit...

Dialogu ishte metoda e pejgamberëve dhe misioni i tyre hyjnor për njeriun. Ata dëshiruan që njeriu të hyjë në shkollën e dialogut, në klasat e para të saj, për këtë nxitën para tij çështje që sfidojnë injorancën e tij dhe horizontet e ngushta, për të nxitur në të natyrën e përballjes, për të pyetur, a për të refuzuar, për të sharë, a për t'u rebeluar, për të gjuajtur me gurë, a për të kërcënuar me vdekje... Çështja ishte që ai të lëvizte brenda vetes së tij, për të dalë nga ngurtësia e heshtjes së kalcifikuar në brendësinë e tij... Ideja ishte të mësonte se si të vëzhgonte drejt Dritës që vinte nga All-llahu."^[2]

Libri që kemi në dorë është i mbushur me kësi momentesh, kur miku ateist gjuan me ironi, padituri e paragjykim, por, autori, një studiues i thelluar dhe një mendimtar jo i zakonshëm, me qetësi e durim, me argumente e dialog, e tërheq mikun e tij nga skëterra e heshtjes së kalcifikuar, nga thellësia e padijes, drejt lartësive të dijes dhe vëzhgimit në fytyrë të Dritës hyjnore, që vezullon si dielli për këdo që i është

treguar rruga drejt saj, me urtësi e pjekuri.

Kjo më sjell ndër mend një rrëfim të dijetarit të madh të botës tonë islame, Hoxhës tonë Sheikh Ahmed Keftaro, të cilin e kam dëgjuar nga afër të tregojë këtë dialog tijin me Papa Gjon Palin e dytë, para shumë vitesh në Vatikan.

Thotë: "Në vitin 1990 më ftoi Papa që të mbaj një referat para konferencës së kardinalëve. Tema e referatit tim ishte: "E ardhmja e dy feve, Islamit dhe Krishterimit, në kohët moderne". Pas kësaj u zhvillua edhe takimi ynë privat. Ndër të tjera e pyeta Papën: A e din, zotëria e jote, se kush është shkaktar i ateizmit dhe komunizmit në

ËSHTË NJË LIBËR QË LEXOHEJ ME KUJDES, POR QË VLEN PËR SECILIN PREJ NESH, SIDOMOS NË KOHËRA SI KËTO, KUR THUAJSE NGA ÇDO DREJTIM DËGJOJMË SULME TË PANDËRPRERA NDAJ ISLAMIT DHE MUSLIMANËVE.

botë? Tha: Kush? I thashë: Ti! (E pashë se u trazua dhe kishte të drejtë) Ma ktheu: Unë? I thashë: Po, ti! Edhe unë bashkë me ty! Ne njerëzit e fesë jemi shkaktarë të ateizmit dhe komunizmit në botë! Kur ne e paraqesim fenë në një formë të shëmtuar dhe ia pengojmë njeriut pamjen e bukur të saj, pastaj i themi të bardhës e zezë dhe të zezës e bardhë, a do të besojnë në fjalët tona? E pamundur!

Pastaj, në fund të takimit, teksa po ndaheshim dhe po përqafoheshim, Papa më tha: Unë e lexoj Kur'anin çdo ditë!"^[3]

Para shumë vitesh, Hoxha rahmet pastë, Sheikh Vehbi Sulejman Gavoci, më dhuroi me dedikim një libër të historianit dhe mendimtarit të shquar sirian, Dr. Sheuki Ebu Khalil. Libri

MYFTIU I DREJTOHET BESIMTARËVE ME NJË MESAZH SHPRESE

Ditën e xhuma, më 13 mars 2020, ashtu siç u njoftua edhe zyrtarisht nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, pas gjendjes së krijuar pas evidentimit të rasteve të para me virusin e COVID-19 në vendin tonë, u anuluan tubimet e ndryshme fetare e kulturore në xhamitë tona, përfshi edhe namazin e xhumasë.

Në këto kushte të papritura e të padëshirura për besimtarët, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua besimtarëve me një mesazh shprese dhe udhëzimi, në mungesë të një hytbeje të unifikuar që ishte planifikuar të mbahej në të gjitha xhamitë e Shkodrës.

Myftiu foli mbi vlerat e pastërtisë në fenë islame dhe theksoi se muslimani është njeri i pastër, që vjen në këtë botë nëpërmjet rrugëve të pastërtisë, jeton pastër dhe largohet me pastërti.



Në këto kontekste, ai përmendi vendin që ka larja e përgjithshme e gusulit, ajo e abdesit, pastrimi i gojës, parfumosja, mbajtja pastër e oborreve, e rrobave, etj., në jetën e muslimanit.

Myftiu tha se shembulli më i mirë që duhet të pasojnë muslimanët edhe në këtë rast është Hz. Muhammedi (a.s.), që ishte model i pastërtisë dhe disiplinës në jetë.

titullohet: "Dialogu, përherë - Dialog me një orientalist".

Në parathënien e tij të kësaj kryevepre, Dr. Ebu Khalil, ndër të tjera shkruan: "Që nga muaji i tretë i vitit 1992, kam menduar të ulem e të shkruaj një libër që në mes të dy kopertinave të tij të përmbajë këtë temë: (Dialogu, në fillim... Dialogu, përherë).

Dialogu në fillim, në mesin e shoqërisë së vetme islame. Dialogu në fillim, në mesin e shoqërive të ndryshme islame, përtej burimeve dhe bindjeve. Dialogu në fillim, në mesin e medhebeve islame, synite e shiite.

Dialogu në fillim, në mesin e islamikëve dhe laikëve. Dialogu në fillim, në mesin e muslimanëve dhe pasuesve të Librit. Dialogu përherë, për të ruajtur kontaktet, për ruajtje miqësinë, për të rrugëtuar bindshëm drejt së vërtetës, larg fanatizmit, bazuar mbi rregullin: Argumento, pastaj beso! Jo të besosh, pastaj të shtrembërosh tekstet drejt asaj që përputhet me besimin tënd! Dialogu në fillim... në zbatim të urdhrat të All-llahut të Madhëruar: "Nuk ka dhunë në fé, është sqaruar e vërteta nga e kota"^[4], apo ajetit kur'anor: "I dërguari ka obligim vetëm komunikimin e qartë".^[5]

Dialogu përherë, për të realizuar unitetin e rreshtave, përndryshe tufani

po vjen dhe do të na marrë para të gjithëve!"^[6]

Në mbyllje,

Meqë ditëve të fundit, bota mbarë po sensibilizohet me emigrantët sirianë, që vijnë nga djepi i dhunuar barbarisht i qytetërimeve dhe civilizimeve botërore, emigrantë që po vriten e po dhunohen dyerve të kufijve të Evropës, po citoj një pasazh nga libri që kemi para duarve, ku autori thotë: "Ata, të cilët e akuzojnë Islamin me prapambetje politike, u themi, se Islami ka ardhur me më shumë dispozita përparimtare në sistemin e qeverisjes.

Respektimi i individit në Islam ka arritur kulmin dhe i ka paraprirë kartës së të drejtave të njeriut dhe është superior ndaj saj. Çfarë vlen një individ i vetëm në Islam? Ai vlen sa tërë njerëzimi mbarë! Në Kur'an urdhërohet: "Kush vret një njeri të pafajshëm apo bën shkatërrime në tokë, është sikur të ketë vrarë mbarë njerëzit dhe kush e shpëton atë, është sikur t'i ketë shpëtuar të gjithë njerëzit!"^[7]

Nuk kanë asnjë vlerë arritjet, as reformat materiale, as ndërtimi, as digat dhe as fabrikat, nëse udhëheqësi vret një njeri të vetëm padrejtësisht në rrugën e këtij reformimi, sepse konsiderohet sikur të ketë vrarë mbarë

"Çfarë të ndalon që të jesh i pastër? Çfarë të ndalon që të mbahesh? Çfarë të ndalon që të kujdesesh për higjienën tënde? Nuk ka asnjë pengesë sot, kur gjithandej ka mjete të shumta e të shumëllojshme pastrimi. Resulull-llahu (a.s.) porosiste shokët e tij: "Mbani pastër mjetet tuaja, pastroni rrobat, që të jeni si nishan në mesin e njerëzve!", në mënyrë që muslimani të dallohet si nga larg, ashtu edhe nga afër për pastërtinë e tij!" – tha ndër të tjera Myftiu.

Ai iu drejtua besimtarëve që të mos bien në panik pas lajmeve të shumta që janë përhapur dhe rregullave të reja të ndërmarra për kufizimin e lëvizjes, por jo vetëm.

Ai u lut dhe kërkoi nga besimtarët që në këto ditë të adhurimit e agjërimeve vullnetare, të shtojnë lutjet, agjërimin e sadekanë dhe të shpresojnë më të mirën nga Zoti i gjithësisë.

njerëzimin.

Ky është kulmi i respektimit të individit, që nuk e ka arritur asnjë rrymë politike, e vjetër apo e re. Individi në Islam ka vlerë absolute, ndërkohë në të gjitha rrymat politike, ai ka vlerë relative. Individi në Islam është i sigurt në shtëpinë e tij dhe në sekretet e tij: "nuk ka përgjime e as përgojime"; i sigurt në pasurinë, rizkun, pronat dhe liritë e tij."^[8]

Faleminderit, i nderuar thirrësi islam, Hoxhë Lavdrim Hamja, për këtë punë të palodhur, për këtë kontribut me vlerë, për këtë ngacmim të dobishëm për secilin prej nesh!

Shkodër, më 6 mars 2020

[1] Kur'ani, El-Bekare: 30.

[2] Ajetull-llahil-udhma Es-Sejjid Muhammed Husejn Fadlull-llah, El-Hivar fil-Kur'an, botimi i pestë, Darul-Melak, Bejrut, 1996, f. 5-6.

[3] Për më shumë, mund të ndiqet regjistrimi audioviziv nr. 22 i tefsirit të sures Abese nga Kryemyftiu i Sirisë, Sheikh Ahmed Keftaro.

[4] Kur'ani, El-Bekare: 256.

[5] Kur'ani, En-Nur: 54.

[6] Dr. Sheuki Ebu Khalil, El-Hivaru daimen - hivar mea musteshrik, botimi i tretë, Darul-Fikr, Damask, 1994, f. 5-6.

[7] Kur'ani, El-Maide: 32.

[8] Dr. Mustafa Mahmud, Dialog me mikun tim ateist, përktheu në shqip: Lavdrim Hamja, Shkodër, dhjetor 2019, f. 59.

TË KTHEHEMI NGA VLERAT E BESIMIT DHE TË LUTEMI ME ZEMËR PËR MËSHIRË E BEKIM!

Në kushtet e kësaj gjendjeje të re që u krijua jashtë vullnetit tonë, në të cilën jemi përfshirë të gjithë së bashku, të rrethuar nga interesimi i vazhdueshëm, diku-diku me frikë, ankth, stres, diku edhe panik, është mirë që herë pas here të këshillohemi e të përhapim mesazhe shprese dhe optimizmi, që na ndihmojnë për ta përjetuar këtë moment me qetësi e besim, larg çdo thirrjeje që nxit pasiguri e dyshime në mesin e njerëzve.

Të dashurit e mi,

Ne si besimtarë, jemi njerëz të jetës, të ndërtimit të saj, të shpresës e të besimit në Një Zot! Duhet të jemi të vetëdijshëm se nuk ka asnjë situatë a realitet në botë, që mund të na pengojë për ta jetuar jetën me krejt gjendjet e saj, të mbështetur në një besim të madh e të palëkundur në Zotin, që e bën gjithsecilin prej nesh të aftë e të fortë për të jetuar në harmoni dhe paqe me veten, sepse jemi në harmoni e paqe me Zotin e gjithësisë.

Në Kur'an ka versete që bëjnë fjalë edhe për lutjen dhe adhurimin në gjendje lufte. Po të ndalemi e të lexojmë me vëmendje këto versete, do të kuptojmë se qëllimi i tyre nuk është nxitja e tmerreve e frikës nëpërmjet luftrave, porse thirrja e shenjtë drejtuar njeriut, që edhe në luftë po të jetë, mos ta harrojë Zotin e tij, mos ta humbë shpresën, mos të bjerë në dëshpërim e demoralizim!

Ne jemi ftuar të jetojmë me dritën e Zotit dhe udhëzimin e Tij. Me fjalë të tjera, besimi në Zotin e gjithësisë na jep forcë e kurajo për të mos e humbur ekuilibrin në jetë, përtej situatave të ndryshme dhe sprovave të jetës!

Pra, mos të ndikojë asnjë faktor i jashtëm me të cilin mund të përballët krejt natyrshëm njeriu në jetë, si: varfëria, skamja, mjerimi, sëmundja, sprovat e ndryshme, etj., për ta larguar nga ekuilibri i besimit, sepse ky ekuilibër është ai që na mban përherë në formën e shembullit të njeriut mëkëmbës i Zotit në tokë!

Jeta e kësaj bote është kalimtare dhe arenë sprovash, ku ne jemi të ftuar të japim më të mirën nga vetja e jonë, duke u dalluar me cilësinë e sjelljes, veprave, fjalëve, mendimeve dhe qëllimeve fisnike, që na mundësojnë të jetojmë me dinjitet dhe pastërti!

Jemi të ftuar që këto fenomene, me të cilat po përballët jeta e njeriut, t'i analizojmë me qetësi, jo të ngarkuar

emocionalisht. Jo të dalim e të bërtasim me të madhe se: "Ky është gazepi i Zotit", "Ky është kijameti", "Ky asht fundi", e të ngjashme!? Unë ju lutem të distancohemi nga disa thirrje qesharake e të mbështjella me dëshpërim e frikësim, me pesimizëm e panik, që vijnë nga poshtë-lart, nganjëherë të mbështjella edhe me ambalazh fetar?!

Të dashurit e mi,

Feja e Zotit është optimizëm e shpresë për njeriun, jo e kundërta! Rrini të qetë se nuk bëhet kijameti, sa të jemi në këtë botë! Ne nuk jemi thirrësit e kijametit! Ne jemi pasues të thirrjes së bekuar: "Nëse po bëhet kijameti dhe në dorën e ndonjërit prej jush ka një fidan, le ta mbjellë atë!". Pra, ejani të shohim realitetet tona shoqërore, familjet tona, fëmijët tanë dhe edukimin e tyre, rininë tonë dhe arsimimin e saj; se sa e sa fidane kemi nevojë të mbjellim sot, për të korriguar dhe ndrequr tokën jopjellore të "kijameteve", që lulëzojnë në mesin tone, në shoqërinë shqiptare!

Të shohim të keqen dhe të përpiqemi për të ndrequr atë, kudo që ta gjejmë, duke nisur nga vetja, familja e rrethi i ngushtë, sepse në këtë mënyrë i bëjmë një shërbim të madh vetes, shoqërisë, atdheut, kombit e mbarë njerëzimit!

"Shkuma e detit shkon, ndërsa e vërteta, që i sjell dobi njerëzve, ajo do të mbesë", thuhet në Kur'an. Pra, sot njerëzit kanë nevojë të dëgjojnë specialistin, mjekun, shkencëtarin, studiuesin e ditur, njeriun e vlerave, larg zhargoneve zhurmuese, që deri dje shurdhonin njerëzit me fjalë të shumta e pa dobi! Tamam, siç e thotë edhe dijetari i shquar shqiptar, Sheh Qazim Hoxha, në vitin 1934 shkruante: "O njeri! Shkund! Çire maskën e apathís, grise perden e gafletit (hutimit)! Të mirat e paqëndrueshme, stolit formale që do të keshë në jetën t'ande nuk duhet me të bërë qiri t'a harrojmë qëllimin e krijimit t'and! Naltësija jote, madhështija e jote duhet t'i drejtohet një idealit më të naltë!".

Mos të harojmë se e sotmja dhe e ardhmja qëndrojnë mbështetur mbi bazat e besimit! Prandaj, të kthehemi nga vlerat e tij dhe të lutemi me zemër për mëshirë e mirësi, bekime e begati për ne dhe racën njerëzore!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

(Përmbledhje e videomesazhit të dhënë, më 17 mars 2020, në kushtet e pandemisë së COVID-19)

QENDRA KULTURORE ISLAME E QYTETIT TË BRESHIAS



Muhamed Giaquinto, musliman italian, vdiq në moshën 82 vjeçare. Ai e përqafoi Islamit gjatë kohës kur ishte në Somali, ku kishte shkuar për një mision italian, rreth vitit 1982.

Një nga muslimanët më të vjetër të qytetit të Breshias, një baba i butë dhe një njeri i sinqertë, vdiq duke qenë i sëmurë prej vitesh, derisa u diagnostikua me korona virus, në mënyrë që të vdesë si një dëshmor.

Qendra Kulturore Islame e qytetit të Breshias, Itali

"Të All-llahut jemi dhe tek Ai e kemi kthimin!"

Të dashur vëllezër dhe motra, sot komuniteti jonë humbi një nga anëtarët e tij të dashur, Muhamed Giaquinto, i cili na la sot në moshën 82 vjeçare. Një musliman italian, i cili e përqafoi Islamit në moshën 60 vjeçare në Somali. Ai ishte gjithmonë aktiv në ndihmë të nevojtarëve në vende të ndryshme në të cilat jetoi.

Giaquinto gjithmonë i jepte shpresë dhe këshilla të mira komunitetin islam të qytetit të Breshias.

Ne qëndrojmë afër familjes së Muhamed Giaquinto gjatë kësaj periudhe të vështirë dhe lusim Allahun (xh.sh) t'u dhurojë durim dhe forcë dhe ta mirëpresë vëllanë tonë të dashur në mëshirën e Tij, ne shtëpinë e paqes, në xhenet. Amin!

Ai punoi me vite si sekretar i Qendrës Kulturore Islame në Tisha dhe meriton lutjet tona më të mira.

All-llahu e pastë ne mëshirën e Tij dhe e pranofte ne xhenet.

Qendra Kulturore Islame, Breshia

Përktheu nga italishtja: Ervil Kuçi



Lavdrim Hamja
Imam - xhamia e "Dy Vajzave"

Të nderuar të pranishëm,

Mustafa Mahmud: (27.12.1921 - 31.10.2009) - Mendimtar, shkrimtar, mjek dhe letrar egjiptian. Studioi mjekësinë dhe u diplomua në vitin 1953, por ai iu përkushtua shkrimit dhe studimit.

Ka shkruar 89 libra shkencorë, filozofikë, shoqërorë, politikë, tregime, novela, mendime fetare e mistike dhe ditarë udhëtimesh. Metoda e tij shquhet për forcën tërheqëse dhe thjeshtësinë që e mbajnë peng lexuesin. Ka paraqitur 400 pjesë nga programi televiziv i njohur "Shkenca dhe besimi".

Dr. Mustafa Mahmud ka ndërtuar një xhami në Kajro, të cilës i ka vendosur emrin e tij "Xhamia Mustafa Mahmud" dhe i ka bashkangjitur asaj në vitin 1979 edhe "Fondacionin Bamiresh Mustafa Mahmud". Ky fondacion përfshin "Spitalin Mahmud" dhe "Klinikën e Syve, Mahmud" dhe klinikat të tjera mjekësore. Shtu këtu edhe Bibliotekën dhe Muzeun Gjeologjik, Muzeun e Gjallesë Ujore dhe Observatorin e Astronomisë.

Rrugëtimi i tij në të kuptuarit dhe në praktikimin e Islamit është interesant, ku vetë ai e tregon duke thënë:

Nganjëherë më vinë prej lexuesve komente serioze dhe pyetje rreth asaj që shkruaj. Disa, shkëpusin thënie prej librave të mi të shkruar që 30 vjet më parë, në përpjekje për t'i treguar njerëzve si kam qenë 35 vite më përpara, me shumë dyshime, pastaj jam bërë besimtar!

Oh, çfarë kontradikte dhe krim që nuk i falet një intelektual!

Siç duket, intelektual i ideal, tek ata, është një copë mermeri që nuk lëviz prej vendit të tij, apo pellg moçali që nuk i ndryshon uji, ose jetë e palëvizshme, e ndenjur, vegël që nuk evoluon!

Në syrin e tyre, idealja dhe e ulëta ka të bëjë me zbulimin e shkrimtarit të gabimeve të tij dhe të mos i korrigjojë,

DR. MUSTAFA MAHMUD - MENDIMTAR, SHKRIMTAR, MJEK DHE LETRAR EGJIPTIAN

apo të heq dorë prej tyre.

E përfytyrojnë perfektën në arrogancën intelektuale, në ngurtësinë, në fanatizmin, në këmbënguljen edhe nëse është gabim (për sa kohë që ky gabim është në interes të tyre)!

Sikur të kisha qenë besimtar që ishte shndërruar në ateist do të më kishin përqaftuar e do të më kishin thënë: Ky është mendimtari i ndershëm dhe i vërtetë. Ky është pionier i kritikës vetjake. Por, kur kritika jonë për vetveten ishte jo sipas epsheve të tyre, ata i goditi verbërimi i ngjyrave dhe të bardhën e panë të zezë, virytin ultësi dhe përgjegjësinë tradhti". - *(Prej librit: Meditime në fenë e Allahut)*

Gjithashtu thotë për veten e ti: Si artist dhe jo më shumë

Asnjëherë nuk kam qenë njeri i fesë (klerik), por artist që kam hyrë në prehrin e fesë prej derës së mirësisë hyjnore dhe prej derës së dashurisë e bindjes dhe jo nga dera e Ez'herit. Gjykimi im ka qenë gjykimi i poetit, i cili e deshi Allahun dhe shkroi për Të vargje dhe ndërtoi një xhami. Por, ai gjithmonë mbeti artisti që në origjinë dhe krijim. Ky artist, pasuria e të cilit është imagjinata dhe ndjenjat.

Arti ka qenë gjithmonë dobësia dhe fuqia ime. Si çdo artist, edhe për mua bukuria ka qenë frymëzim.

Kam qenë njeri gabimtar dhe për këtë arsye asnjëherë nuk kam pretenduar të jem i pagabueshëm.

Prandaj, kurrë nuk më keni parë të debatoj me ndokënd që më ka quajtur gabimtar, ose me dikën tjetër që më ka quajtur të drejtë. Bile, gjithmonë i kam premtuar vetes t'i kthehem asaj që shkruaj dhe ta korrigjoj botim pas botimit. I pres me zemër të hapur kritikën e të tjerëve.

Nëse me sheh të shkruaj diçka të drejtë, kjo është prej mirësisë së Allahut, dhe nëse kam shkruar gabim, kjo është prej cytjeve të vetes sime.

Me këtë shpirt kam pasur gjithmonë dëshirë të më lexojnë njerëzit. Asnjëherë nuk e kam konsideruar veten komentator (mufesir) të Kur'anit, apo gjykatës të çështjeve juridike (fikhu), ose sheriatit, por ato janë përpjekje për të kuptuar prej një mendimtari, roli i të cilit nuk është më shumë se sa të nxisë mendjen dhe ta nxjerrë atë nga gjendja e gjumit. Të zgjojë zemrën prej vdekjes së saj dhe ta hap atë drejt dashurisë së Allahut. Nëse mundem ta mbajë mbi shpinë një njeri

duke u kthyer në rrugën e tij të drejtë dhe që të hapë Mus'hafin (Kur'anin), ky është synimi i mesazhit tim, kulmi i qëllimit dhe skaji i rolit tim.

Ndërsa, për sa i përket kuptimit të këtij njeriu në fenë e tij, ky është roli i dijetarëve të nderuar e të specializuar. Mua më mjafton që e solla te dera e tyre, ia nxita dëshirën, mirësinë dhe ia zgjova gatishmërinë. Kështu që, unë nuk jam dijetar dhe gabon ai që më lexon sikur unë të jem dijetar, por unë jam thjesht artist admirues që mbaron roli i tij në nxitjen e dashurisë së vërtetë dhe për të vërtetën në zemrën e lexuesit të tij. Për këtë le të më llogarisin lexuesit e kritikuesit, dhe jo më shumë.

Për dobësinë time dhe gabimet e mia, askush nuk zotëron, përveç Allahut të më mëshirojë dhe Atij i drejtohem në çdo moment, pa më penguar frika e as shpresa.

"Sikur të më pyesnin: Përse ke besuar? Kërkojmë prej teje një përgjigje me disa fjalë.

Do të thosha me plot bindje dhe pa hezitim: Sepse pa Allahun, nuk ka kuptim ekzistenca ime dhe as ekzistenca e asnjë gjëje! - *(Prej librit: "Turistë në dynjanë e Allahut")*

Në fund, më lejoni që ashtu siç thotë Pejgamberi (a.s) **"Kush nuk falënderon njerëzit nuk ka falënderuar as Allahun"**, të bëj disa falënderime.

Falënderoj të gjithë ata, të cilët bënë shkak ta përkthej dhe botoj këtë libër: Duke filluar nga familja, sponsorizuesin e botimit, një shok dhe mik të mirë të Qendrës Islame Amerikane Shqiptare nga Kenosha, Wisconsin. Allahu i dhashtë mbarësi e suksese në jetën dhe punë.

Falënderim të veçantë edhe për redaktorin e librit, Imam Muhamed Sytari, Myftiun e Shkodrës, për punën me vlerë dhe profesionale, në mënyrë që përkthimi të dalë sa më mirë. Allahu i dhëntë shëndet dhe mbarësi.

Falënderim për Myftininë Shkodër, e cila organizoi këtë promovim.

Së fundmi falënderim për të gjithë ju, që sot morët pjesë në këtë promovim me prezencën, dëgjimin dhe durimin tuaj. Allahu ju dhëntë mbarësi dhe lumturi.

Shkodër më, 6.3.2020

(Fjala e mbajtur në promovimin e librit "Dialog me mikun tim ateist" me autor Dr. Mustafa Mahmud)



Arben Halluni, teolog

“Dy fjalë për librin”

Libri “Dialog me mikun tim ateist” që po prezantohet sot i autorit të njohur, Dr. Mustafa Mahmud, përkthyer nga thirrësi islam, Lavdrim Hamja, mendoj se është i dobishëm në çdo kohë, në çdo situatë dhe në çdo vend.

Më mirë se çdo kujt tjetër, ky botim që në fakt jemi të njohur prej kohësh me përmbajtjen e tij, mund ti përshtatet vendit tonë, i cili për fat të keq kaloi në një periudhë të errët 50-të vjeçar, në sistemin famëkeq komuniste-ateist, që në fakt tymi i propagandës së tij të ligë vazhdon te jetë prezent akoma edhe sot dhe që përpiket të instalohet përmes demagogjive hipokrite dhe të një formati multi-doktrinor apo fetar, por që sipas propaganduesve materialiste, ateizmi duhet të jetë në krye të tyre.

Libri më këtë tematikë mendoj gjithashtu se është një lloj vaksinë që i bën ballë çdo virusi, bile edhe këtij të fundit që bota aktualisht në përgjithësi po përjeton një ankth, fobi apo depresion, përveç atyre që kanë si mbështetje besimin dhe që i kuptojnë dhe zbatojnë mirë parimet e fesë.

Në fakt në këtë libër dialogu me mikun ateist ka shumë tematika, duke filluar me atë: Që Zoti nuk është i lindur dhe nuk ka lindur kush prej tij e deri te tema e fundit: Fituam me lumturinë e dynjasë dhe fituat iluzione...

Dy tema, disi të përafërta me njëra tjetren dhe që më kanë tërhequr më shumë dhe që mendoj ti ndajë me ju sot disa mendime dhe komente shtesë janë në lidhje; Nëse Allahu m'i ka përcaktuar veprat e mia, atëherë përse më merr në llogari si dhe përse Allahu e ka krijuar të keqen(sherrin), pra ndryshe çështja e Kadasë dhe kaderit?...

Fillimisht, të parët tanë e kanë konsideruar çështjen e besimit në

KADAJA DHE KADERI NË LIBRIN: “DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST”

Kadanë dhe Kaderin (Caktimi i Allahut)të një rëndësie të veçantë. Vazhdimisht atë e kanë konsideruar si motiv për veprim dhe nxitës për të pranuar kënaqësinë e Krijuesit. Ata nuk kanë njohur, siç bëjnë tani shumë njerëz, mërzitjen e kohës, urrejtjen e jetës, pesimizmin dhe dorëzimin para fatkeqësive etj.

Tregohet një herë se Omer ibn El-Khatib (r.a) iu drejtua Shamit dhe gjatë rrugës takoi disa udhëtarë të cilët e informuan atë, se atje për ku ishte nisur ishte përhapur kolera. Menjëherë Hz. Omeri u konsultua me muhaxhirët (emigrantët) dhe ensarët (ndihmëtarët). Muhaxhirët ishin të mendimit që të ktheheshin. Hz. Omeri iu përgjigj mendimit të tyre dhe pranoi. Kurse Ebu Ubejdah Bin El-Xherah tha: “A po ikim nga Kaderi i Zotit?”. – Ndërsa Hz Omeri i tha: “...Po, po ikim nga Kaderi i Allahut për tek një Kader tjetër i Allahut...”.

Kaderi (përcaktimi) nuk mohon lirinë e njeriut në veprimet e tij dhe nuk i shkakton imponim, sepse Kadaja e Allahut është e lidhur me diturinë e Tij të hershme, për të cilën njerëzit nuk dinë gjë.

Siç e thotë edhe vetë autori në librin e tij: Veprat nuk janë të përcaktuara me imponim kundër vullneti tënd. Ato janë të përcaktuara në dijen e Zotit.

Me këtë kuptojmë se: Njeriu është i urdhëruar të veprojë të mirën dhe si shkëmbim atij i premtohet shpërblimi. Ndërsa veprën e keqe Allahu e ka ndaluar duke e paralajmëruar se do të pësojë dënim në rast se e vepron atë. Nuk ka kuptim për shpërblimin dhe as për dënimin vetëm atëherë kur vepra rrjedh nga liria dhe zgjedhja.

Po t'i kthehemi disa ajete kur'anore të cilat na qartësojnë këtë koncept do mundemi ta ndajmë lirinë në dy pjesë:

Pjesa e parë: Përfshin ajetet që tregojnë se njeriu është përgjegjës për veprën e tij.

Për shembull ndër ajetet që flasin për këtë koncept janë:

“Secili njeri është peng i asaj që ka punuar” - (Kur’ani, Et-Tur: 21)

“E kush e merr rrugën e drejtë, ai e ka vetëm për veten e vet, ndërsa kush e merr të shtrembëron, ai e ka humbur veten. Unë nuk jam rojë e juaj!” - (Kur’ani, Junus: 108)

“Kush bën mirë, ai e ka për vetë, e kush bën keq, ai vepron kundër vetes, e Zoti yt nuk bën padrejtësi ndaj robërve” - (Kur’ani, Fussilet: 46)

“Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit...” - (Kur’ani, El-En’am: 164)

Pjesa e dytë: Përfshin shpërblimin mbi veprimin.

Ajetet kur'anore për këtë pjesë janë të konsiderueshëm si p.sh:

“Dhe secili njeri shpërblehet për atë që ka vepruar, e Ai më së miri e di se ç’punuan” - (Kur’ani, Ez-Zumer: 70)

“Dhe nuk ndëshkoheni për tjetër, përveç për atë që vepruat” - (Kur’ani, Es-Safat)

PO TË DONTË ALLAHU (XH.SH) QË TË GJITHË NJERËZIT TË JENË BESIMTARË DO T’I DETYRONTE DREJT BESIMIT, POR MADHIA E TIJ ABSOLUTE I LA TË LIRË, PASI UA NDRIÇOI ATYRE RRUGËN E UDHËZIMIT PËR TË CILËN ËSHTË I KËNAQUR DHE I LA PO TË LIRË PASI I PARALAJMËROI PËR RRUGËN E HUMBES, PËR TË CILËN AI SHPREHU URREJTJEN.

Në ajetet e lartpërmendura arrijmë të themi se njeriu është përgjegjës për veprimet e tij, sepse është i lirë po në veprimet e tij, shpërblehet për të dobishmen e nënshtrimin dhe dënohet për arrogancën e tij. S’ka dyshim se Allahu (xh.sh) nuk i bën askujt të padrejtë prej krijesave të Tij.

Po të donte Allahu (xh.sh) që të gjithë njerëzit të jenë besimtarë do t’i detyronte drejt besimit, por Madhnia e Tij absolute i la të lirë, pasi ua ndriçoi

atyre rrugën e udhëzimit për të cilën është i kënaqur dhe i la po të lirë pasi i paralajmëroi për rrugën e humbjes, për të cilën Ai shprehu urrejtjen. Pra me anë të lirisë dhe zgjedhjes njeriu o mund të fitojë shpërblimin ose dënimin.

Këtu konkludojmë ashtu siç e thotë edhe autori Dr. Mustafa Mahmud se: ...Liria është relative dhe jo liri absolute, pra jo mbizotëruese ndaj vullnetit të Zotit... Ti pa dyshim je i lirë të frenosh epshet tuaja, të zotërosh zemërimin, t’i rezistosh vetes. T’i ndalosh qëllimet tuaja të këqija dhe t’i nxitsh dëshirat tuaja të mira...

Në Kur’anin famëlartë ka ajete që fraksioni i quajtur “El-Xhebrijun” hamendësojnë se mbështesin doktrinën e tyre, si p.sh fjala e Allahut xh.sh: “Allahu ua mylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të pamirit e tyre ka një perde, e ata kanë një dënim të dhembshëm”. Fjala e Allahut nëpërmjet gjuhës së Nuhit (a.s) për popullin e tij. “Nëse përpiqem t’ju këshilloj, po qe se Allahu do t’ju humbë, këshilla ime nuk ju bën dobi. Ai është Zoti juaj...” - (Kur’ani, Hud: 34) Dhe fjala e Allahut nëpërmjet gjuhës së banorëve të xhennetit: “...Falënderojmë Allahun që na udhëzoi për këtë(për iman, për punë të mira, na hoqi zilinë, na futi në xhennet), pse sikur të mos na drejtonte Allahu, ne nuk do të dinim të udhëzohemi...” - (Kur’ani, El-A’raf: 43)

Këto ajete kur'anore dhe të tjerë si këto nuk përcjellin mesazhin e detyrimit apo imponimit, siç pohojnë gabimisht “El-Xhebrijunët”, por do të thotë se dija e Allahut ka paraprirë se disa nga robërit e Tij do të ndjekin kufirin (mosbesimin) dhe mosbindjen ndaj profetëve të tyre. Kështu Krijuesi i gjithësisë vendosi sipas asaj çka parapriu në dijen e Tij, sikundër parapriu dija e Allahut që disa nga robërit e Tij do të ndjekin rrugën e besimit dhe udhëzimet e profetëve dhe si rrjedhojë Allahu (xh.sh) vendosi sipas asaj që dinte në fillim.

Ky koncept është i qartë në disa ajete kuranore: “Kush i kundërvihet të dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që e ka zgjedhur(në këtë botë materiale) e i fusim në xhehenem...”, (Kur’ani, En-Nisa: 115). Ky ajet kuranor bën të qartë se ata që gënjen të dërguarin pasi iu bënë të qartë faktet për të besuar atë si profet i Allahut (xh.sh), ishin pikërisht ata që zgjedhën për veten e tyre errësirën dhe humbjen e udhëzimit. Për këtë qëndrim dija e Allahut u parapriu, kështu Madhniploti i la që ta zgjedhin vetë,

por jo se Allahu është razi(i kënaqur) me mosbesimin e arrogancën e njerëzve. Pra, Krijuesi i gjithësisë vendosi për dënimin e tyre si rrjedhojë e mosbesimit të tyre.

Gjithashtu fjalët e Allahut xh.sh: “...E kur ata u shmangën(nga e vërteta), Allahu i largoi zemrat e tyre, pse Allahu nuk e vë në rrugë të drejtë popullin e prishur”(Kur’ani, Es-Saff: 5), qartësojnë se njerëzit e prishur janë në humbje. Pikërisht për këtë dija e Allahut e ka regjistruar ecurinë e tyre të humbjes. Kështu Madhniploti i largoi zemrat e tyre. Sa ishin të lirë për atë që zgjedhën ishin edhe të meritueshëm për dënimin.

Mendoj që në këtë kuadër të sqaroj një nga çështjet kryesore të kësaj teme: Ka disa njerëz që kur lexojnë ajetin kuranor. “E Allahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni”, (Kur’ani, Es-Safatë: 96), hamendësojnë se Allahu Fuqiplotë u drejtohet krijesave të Tij. Mirëpo e vërteta është se është Ibrahim (a.s), që i drejtohet popullit të tij, i cili adhuronte statuja e idhuj të cilat i bënë me duart e tyre. Ky popull i larguar nga besimi i drejtë së bashku me statujat e veta është nga krijesat e Allahut. Me këtë logjikë sa nuk është normale, nuk është as e natyrshme që ato(idhujt) të adhuroheshin, sepse ishin të prodhuar nga dora e njeriut. Statujat në kohën e profetit Ibrahim (a.s) nuk ishin gjë tjetër vetëm gurë ose drunj të gdhendur, të krijuar me fuqinë absolute të Allahut xh.sh, “Ai (Ibrahimi) tha: “A adhuroni atë që vetë e keni gdhendur?”. E Allahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni”. - (Kur’ani, Es-Safat: 95-96).

Pra, Kadaja (që do të thotë vendim) dhe kaderi (përcaktim dhe renditje e organizuar) nuk është imponim ndaj njeriut përkundër natyrës dhe vullnetit të tij, do të thoshte dialoguesi me mikun e tij ateist..., i cili duke përforcuar akoma më shumë argumentin e tij citon një dijetar të madh islam, Ebu Hamid El-Gazali, i cili çështjen e “zgjedhjes së lirë” dhe “imponimit” e ka përkufizuar kështu: Njeriu është i lirë për atë që di dhe është i imponuar për atë që nuk e di...pra çka do të thotë se sa në shumë që shtohet dituria(e fituar ose dija hyjnore e dhuruar-ledunitë), aq më tepër shtohet fusha e lirisë...

Besimi ynë në Kadanë e Allahut dhe në Kaderin e Tij jep në brendësi të shpirtit mjaft mirësi, sepse besimtari në çështjen e Kadasë bëhet i fortë e përbalues, për arsye se e kupton se çdo gjë që ndodhë në këtë botë lëndore si vdekje apo jetë, shëndet apo sëmundje,

dobi apo dëm, varfëri apo pasuri është e paracaktuar në dijen e Allahut. Ai që beson në Kadanë e Allahut është e pamundur t’i nënçmohet kujt dhe është e pamundur të ndyjë ndërgjegjen e nderin e tij, sado që çmimi i trillimit të jetë i paparë, ngase është i bindur se dobia e dëmi janë në dorën(fuqinë) e Krijuesit të gjithësisë, i prirur nga dija e vendimi i Tij. Në qoftë se do të mblidheshin njerëzit e xhindët për të sjellë dobi ose dëm ndaj një krijese, nuk do të mund të arrinin tjetër, vetëm atë që Allahu (xh.sh) ka përcaktuar në bazë të dijes së tij të pakufishme. Besimtari në çështjen e Kadasë është vazhdimisht i kënaqur e optimist në të gjithë çështjet.

Si përfundim, bazuar në ato që kemi lexuar dhe mesuar nga literature islame:

Çështja e kaderit është çështje besimi, kurse debatimi dhe polemizimi me çështjet e besimit nuk është i drejtë, për shkak se tema është delikate. Por, nuk ka ndonjë të keqe nëse kjo temë diskutohet në mënyrë kompetente, konstruktive, pa stërholime dhe ngatërresa.

Njeriu ka kaderin e vet të lidhur me vullnetin e vet, si dhe kaderin e vet që vepron jashtë vullnetit të vet. Duke u nisur nga fakti se mendja e njeriut është e krijuar dhe nuk ka kapacitet t’i perceptojë gjërat metafizike si Krijuesin, në pajtim me mësimin islam, ajo nuk do të mund t’i kuptojë të gjitha urtësitë dhe misteret e kaderit. Të tilla fshehtësi të kaderit janë: vendlindja, gjinia, prindërit, fatkeqësitë etj. Ato vijjnë nga faktorë jashtë vullnetit të njeriut, prandaj edhe për këtë dimension të kaderit, Pejgamberi (a.s) e ka ndaluar të debatohet e të polemizohet.

Përpjekja e njeriut për ta zgjidhur në mënyrë të prerë çdo specifikë lidhur me kaderin, do të thotë përpjekje për një gjë që e kapërcen kapacitetin e tij.

Pejgamberi a. s. e ka ditur se kaderi është një ndër temat filozofike, në të cilën nuk mund të jepet përgjigje nëpërmjet të arriturave shkencore të kohës së tyre. Polemika në këtë rast do t’i shpinte në hapësirat ku do të lajthiteshin. Për këtë arsye, prioritet i ka dhënë besimit me zemër, bindjes dhe pranimit atë ka caktu Zoti për ne.

Në fund, mbetet ti uroj urime teologut Lavdrim Hamja për këtë libër të përkthyer në gjuhën shqipe dhe që është i kohës për ato njerëzi që e çmojnë kohën duke lexuar dhe u bindur me faktet dhe argumentet e besimit që sfidon në çdo aspekt ateizmin dhe materializimin...



Idmir Plaku,
Imam - xhamia "Ebu Bekër"

Kanë kaluar tre javë që na mungon mesazhi i minberit të Pejgamberit (a.s) për shkak të gjendjes që po përjetohet pothuajse në të gjithë rruzullin tokësor. Asnjëherë nga ai minber nuk ka munguar duaja drejtuar Allahut (xh.sh) për të na dhënë mbarësi në jetën e kësaj bote dhe shpërblim në jetën tjetër. Në këtë realitet të ri, që njerëzimi po përjeton, ku shumë gjëra po ndryshojnë në mënyrën e jetesës, kemi nevojë për lutje të vazhdueshme të shoqëruara me falënderim ndaj Allahut të Madhëruar, që falë mëshirës së Tij hyjnore, njerëzimi ta kalojë këtë gjendje, të cilën po e përjeton, me sa më pak dhimbje.

Në këtë kontekst, mesazhi i kësaj teme, të cilën po trajtoj, është: Duaja në jetën e besimtarit. Duaja për besimtarin është çështje e legjitimuar, e pëlqyer dhe e kërkuar. Duaja-lutja për besimtarin është adhurim, kërkesë e fesë, është dritë që mbush hapësirën qiellore dhe atë tokësore, dritë që ndriçon zemrat

DUAJA NË JETËN E BESIMTARIT

dhe mendjet e besimtarëve.

Me dua besimtarit fshin gabimet dhe gjynahet mbrohet prej sprovave që përjeton në jetën e kësaj bote. Me dua besimtarit fiton kënaqësinë e Allahut dhe largon zemërimin e Tij. Këtë garanci, Allahu i Madhëruar. e premtun duke thënë: "Më thirrni mua, Unë ju përgjigjem"¹, raport i drejtë mes robit dhe Allahut, pa ndërmjetës, shtim i besimit në marrjen e përgjigjes nga Allahu (xh.sh). Në këtë ajet kur'anor, Allahu i Madhëruar. i premtun njeriut përgjigjen e lutjes së tij duke e shikuar atë nga pozita e adhurimit. Kur njeriu ndodhet në pozitën e adhurimit. afërsia me Allahun është e papërfillshme. Në këtë kontekst Allahu i Madhëruar thotë: "E kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë drejt të udhëzuar le të më përgjigjen Mua dhe le të më besojnë Mua, për të qenë drejt të udhëzuar"².

Ndërsa Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Lutjuni Allahut të bindur në përgjigje dhe dijeni që Allahu nuk i përgjigjet lutjes që buron nga zemra e hutuar".³Lutjuni Allahut (xh.sh) duke qenë në gjendje që ta meritoni përgjigjen. Ajo është gjendja e punës, bindjes dhe sakrificës. Duaja e shoqëruar me injorim apo neglizhencë ndaj obligimeve ajo mbetet pa përgjigje.

1. Kur'ani, Gafir: 60.
2. Kur'ani, El-Bekare: 185.
3. Transmeton Imam Ahmedi.

Në lidhje me këtë, Umeri (r.a) ka thënë: "Asnjëri te mos neglizhojë me kërkimin e rrizkut, e të lutet me duar të ngritura drejt qiellit duke thënë: O Allah më furnizo, kur dihet se nga qielli nuk bie as ar e as argjend".

Duaja për besimtarin nuk është e legjitimuar thjesht për të cituar disa fjalë apo shprehje sipas nevojës e gjendjes, pa e ndjerë domethënien e tyre. Duaja është parashtrim i nevojës që ke vetem tek Allahu (xh.sh), ku gjuha shqipton, zemra ndjen dhe mendja logjikon.

Gjatë duasë besimtarit është i vetëdijshëm në atë, që thotë dhe në atë që kërkon, ku tërë qenia e tij është e përqendruar në këtë adhurim. E me të drejtë, Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Duaja është esenca (truri) i adhurimit". Siç vërehet, Pejgamberi (a.s) e ka krahasuar duanë me njeriun e zgjuar, të vetëdijshëm në atë çfarë kërkon. Për besimtarin, duaja i ngjason një dushi me ujë të ngrohtë, që e pastron dhe e gjallëron si në aspektin shpirtëror, ashtu edhe në atë lëndor. Transmetohet se Pejgamberi (a.s) vuri re një person të ulur në xhami, jo në kohë namazi. U afrua tek ai dhe i tha: "Perse je këtu në këtë kohe?" Personi iu ankua për problemet dhe borxhet që kishte. Pasi e dëgjoi Pejgamberi (a.s) e këshilloi duke i thënë: "Kur të zgjohesh apo te ngrysesh thuaj: O Zot, mbështetem në Ty nga dembelizmi, mërzia dhe mjerimi.

**"KUR TË ZGJOHESH
APO TE NGRYSESH
THUAJ:**

**O ZOT, MBËSHTETEM
NË TY NGA DEMBELIZMI,
MËRZIA DHE MJERIMI.
O ZOT, MBËSHTETEM NË
MBROJTJEN TËNDE NGA
RËNDESA E BORXHIT
DHE NGA ZEMËRIMI I
NJERËZVE"**

O Zot, mbështetem në mbrojtjen Tënde nga rëndesa e borxhit dhe nga zemërimi i njerëzve".⁴

Po t'i lexojmë me kujdes mesazhet që përcjell Pejgamberi (a.s) në këtë hadith, vërejmë se lutja e besimtarit duhet të bëhet në pozitën e adhurimit. Në thënien: "ishte ulur në xhami në një kohë jashtë nemazit", d.m.th: ishte kohë për të qenë në vendin e punës, duke kërkuar rriskun dhe kjo është një mënyrë adhurimi. Ndërsa në thënien: "kur te zgjohesh apo ngrysesh", d.m.th: duaja për besimtarin është garanci e qetësisë dhe gjallërim i aktivitetit njerëzor.

Duaja nuk duhet kuptuar si një vizë transiti për të arritur atë që kërkon. Nëse njeriu lutet me sinqeritet, Allahu (xh.sh) do t'i përgjigjet, ose duke e shpejtuar përgjigjen, ose duke ia rezervuar për më vonë sipas asaj që ka përcaktuar, ose duke ia zëvendësuar me diçka më të mirë sesa ajo që i ka kërkuar në duanë tij.

Duaja e sinqertë për besimtarin është arma më e fortë e tij. Ajo mbetet përherë derë e hapur e shpresës në mëshirën e Allahut dhe e komunikimit me Të. Allahu i Madhëruar na ka sjell shembuj nga jeta e Pejgamberëve, ku ia mësynë kësaj dere për të realizuar nevojat e tyre. Në suren El-Enbija, ajeti 83-90, Allahu (xh.sh) urdhëron e thotë: "Përkujto edhe Ejubin, kur iu drejtua Zotit të vet me lutje: Më gjeti belaja, e Ti je më Mëshiruesi ndër

mëshiruesit! Ne iu përgjigjem atij nga mëshira Jonë, ia hoqëm ato vështirësi që i kishte, i dhamë familjen e tij dhe aq sa ishin ata dhe e bëmë përkujtim për të devotshmit. Përkujto edhe Ismailin, Idrisin dhe Dhulkiflin, që të gjithë ishin te durueshëm. Ata i përfshimë në mëshirën Tonë, se ishin vërtet prej të mirëve. Përkujto edhe atë të peshkut, Junusin kur doli i hidhëruar prej popullit dhe mendoj se nuk do t'i vijë më puna ngushtë, po në errësira ai tha: Nuk ka Zot, përveç Teje! Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtësi vetes sime! Ne iu përgjigjem atij, e shpëtua nga tmerrri. Kështu i shpëtojmë Ne besimtarët.

Përkujto edhe Zekerianë, kur e luti Zotin e vet: Zoti im, mos më lë të vetmuar, se Ti je më i miri trashëgues {pas çdokujt}. Ne ia pranua lutjen e tij, ia dhuruam atij Jahjanë dhe ia përmirësua bashkëshorten e tij. Ata përpiqeshin për punë të mira, na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj nesh."

Duaja në jetën e besimtarit është shoqëruesja më e mirë e tij. Ajo e shoqëron në raste gëzimi e hidhërimi. Kush gjen shoqërinë e saj, patjetër që ka marrë e përgjigjen për të. Të gjithë kemi nevojë për t'i bërë lutje Allahut, shoqëruar me falënderim për mirësitë e shumta që na ka dhënë. Kur këto mirësi i humbasim, atëherë ua dimë vlerën e vërtetë. Besimtarit nuk është prej atyre, që e humbet këtë gjë. Allahu i Madhëruar. në suren Hud, ajeti: 107, thotë: "Nëse Allahu të sprovon me ndonjë të keqe, atë s'mund ta largojë kush pos Tij, po nëse dëshiron të të japë ndonjë të mirë, s'ka kush që mund ta pengojë dhuntinë e Tij. E shpërblen me të, atë që do nga robërit e Tij. Ai falë e mëshiron shume".

Të nderuar vëllezër e motra besimtare,

Të gjithë ne t'i lutemi Allahut (xh.sh), të bindur në përgjigjen e Tij që ta largojë këtë të keqe që ka vështirësuar jetën. T'i lutemi Allahut që të na i falë gjynahet dhe të jemi në mëshirën e Tij. T'i lutemi Allahut të Madhëruar, që të jemi prej atyre besimtarëve, të cilët i luten në vështirësi dhe në rehati. Vlerësojeni lutjen si një mirësi, që Allahu (xh.sh) jua ka dhënë. Umeri (r.a) ka thënë: "Personit që Allahu (xh.sh) i ka dhënë lutjen, nuk i është ndaluar përgjigja", sepse Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem!"

4. Transmeton Muslimi.



**I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S)
KA THËNË:**

*"Më e
mira lutje
është
istigfari
(kërkimi
falje
All-llahut)!"*

(Transmeton Hakimi)

SHTETI I KATARIT

Shteti i Katarit është një gadishull, i cili gjendet në mes të bregdetit perëndimor të Gjirit Arabik.

Katari kufizohet me Mbretërinë e Arabisë Saudite në anën jugore të tij, kurse nga ana e detit kufizohet me Bahrejin në veriperëndim, me Iranin në veri dhe verilindje dhe me Emiratet e Bashkuara Arabe në anën juglindore.

Ky vend ka një sipërfaqe prej 11.521 km katrorë, ndërsa numri i popullsisë shkon në afërsisht 2,865,200 banorë.^[1]

Katari ka shumë ishuj, ku nga më të mëdhenjtë janë ishujt Hālūl, Shiraua dhe El-Es'hat.

El Vekra, El Khur, Dukhan, Esh-Shemāl, janë nga qytetet më të mëdha në Katar, kurse Doha është kryeqyteti i vendit.

Doha, në gjuhën arabe do të thotë: Pemë e madhe, me hije të freskët.^[2]

Sipas dëshmimeve arkeologjike, gërmimeve, mbishkrimeve dhe qeramikave të pakta të gjendura në zona të ndryshme të vendit, Gadishulli i Katarit, si vendbanim për njerëzit, daton qysh afro katër mijë vjet përpara erës sonë.

Historiani grek, Herodoti, në shekullin e 5-të para erës sonë, do të shënonte se banorët e parë të Katarit

ishin fise Ken'an, të cilët ishin të njohur për lundrimet e tyre dhe për tregtinë nëpërmjet rrugëve detare.

E ashtuquajtura "Harta e Arabisë", e gjeografit grek Ptolemeut, përfshinte edhe atë vend që ai e quante "Katra" dhe që mendohet t'i referohet qytetit Zubara, i cili në ato kohë konsiderohej të ishte një nga portet më të rëndësishme tregtare në zonën e Gjirit Arabik.^[3]

Katari ka klimë shkretëtire, me verë të nxehtë, dimër të ngrohtë dhe shi të rrallë. Gjatë verës temperaturat arrijnë deri në 50 gradë celsius, kurse në dimër sillen midis 7 dhe 24 gradëve celsius.

Feja zyrtare e Shtetit të Katarit është Islami dhe Sheriati Islam është burimi kryesor i legjislacionit në vend.

Gjuha Arabe është gjuha zyrtare e Shtetit të Katarit. Gjuha Angleze është gjuha e huaj që flitet gjerësisht atje, pas gjuhës amtare.

ISLAMI NË KATAR

Në kohën kur u shfaq Islami, toka e Katarit dhe zonat pranë saj, ishin nën sundimin e El-Mundhir ibn Savi.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, i dërgoi atij një letër me anë të sahabiut të shquar El-Alā ibn El-

Hadramij, ku e ftonte në Islam.

Ai iu përgjigj pozitivisht ftesës së Profetit Muhamed (a.s), dhe e pranoi fenë e Zotit, e bashkë me të e pranuan edhe një pjesë e madhe e vartësve të tij arabë.

Burimet e historisë arabe islame, sjellin prova të shumta për aftësinë e madhe të banorëve të Katarit për lundrimet në det dhe për pjesëmarrjen e tyre në përgatitjen e flotës së parë detare, që do të mbartte ushtrinë islame, të komanduar nga sahabiu El-Alā ibn El-Hadramij (r.a). Gjithashtu, në Katar u instalua një kamp ushtarak i ushtrisë muslimane, përveç kampeve që ata i kishin në jug të Irakut.

Katari hyri në procesin e Civilizimit Islam, në fazat dhe epokat e tij të njëpasnjëshme, që nga epoka e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, duke vazhduar me epokën e Kalifëve të Drejtë, epokën e Emevitëve, epokën Abaside...

Gjatë epokës Abaside, në shekullin e dytë të hixhretit, Katari dëshmoi prosperitet ekonomik, që iu mundësua nga Shtëpia e Kalifatit, në Bagdad.

Në vitin 922 hixhri, portugezët e pushtuan Katarin, dhe qëndruan aty deri në vitin 963 hixhri, kur sulltan Sulejmani i Madhërisëm, arriti ta çlironte prej tyre.

Doha, kryeqyteti i Katarit



Deri në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, udhëtarët evropianë dhe krijuesit e hartave në përgjithësi, e konsideronin Katarin si pjesë të Bahrejnit.

Historia moderne e Katarit fillon në shekullin e tetëmbëdhjetë, kur fiset e Katarit të udhëhequra nga familja Āl-Thāni u organizuan dhe vendi mori rrugën drejt stabilitetit, si i pavarur nga fqinjët e tij, por duke krijuar marrëdhënie të ekuilibruara me palët e ndryshme me ndikim në rajon.

Në 1868, Sheik Muhamed ibn Thāni, nënshkroi një marrëveshje me autoritetet britanike në Gjirin Arabik, me anë të së cilës Katari u njoh si një entitet i pavarur politik dhe Britania u zotua ta mbrojtë Katarin nga çdo agresion i jashtëm.

Në çerekun e fundit të shekullit XIX, Katari hyri nën ombrellën e Kalifatit Osman. Vendi do të vazhdonte të sundohej nga Sheik Xhassim ibn Muhamed Āl-Thāni (i cili i mbajti lidhjet e tij me shtetin e Kalifatit, pavarësisht dallimeve në qëndrimet ndaj disa çështjeve), deri në vdekjen e Sheikut (më 17 korrik 1913) dhe fillimin e Luftës së Parë Botërore.

Më vitin 1916, Sheik Abdullah ibn Xhassim Āl-Thāni, që ishte sunduesi i Katarit asokohe, nënshkroi një traktat mbrojtjeje me Britaninë.

Në vitin 1935 Sheik Abdullahu e ripërtëriu atë traktat dhe i dha

kompanisë Anglo-Persiane të petrolit, një koncesion për të eksploruar për naftë në vend. Me këtë rast u ra dakord edhe për lejimin e një të emëruari britanik në Katar, gjë e cila u realizua në vitin 1949.

Më 3 shtator 1971, Sheiku Khalifa ibn Hamd Āl-Thāni, Princ i Kurorës dhe Kryeministër asokohe, shpalli përfundimin e Traktatit të vitit 1916, duke shënuar një fazë të re në historinë e vendit. Qeveria mori në dorë drejtimin e plotë të vendit, dhe Katari u bë një vend i pavarur.^[4]

Katari është një vend ku është vendosur një nga mediat më të rëndësishme ndërkombëtare, përkatësisht rrjeti mediatik prestigjioz Al Jazeera. Al Jazeera flet në gjuhë të ndryshme krahas arabishtes, si Al Jazeera English, Al Jazeera Balkan, Al Jazeera Turkey dhe Al Jazeera America

RRETH MARRËDHËNIEVE DYPALËSHE, SHQIPËRI-KATAR

Marrëdhëniet diplomatike midis Republikës së Shqipërisë dhe Shtetit të Katarit u vendosën më 26 gusht 1992. Marrëdhëniet midis dy vendeve janë zhvilluar në mënyrë miqësore e të qëndrueshme.

Shqipëria hapi ambasadën e saj në Doha në janar të vitit 2011 dhe një vit më pas, në janar 2012, Shteti i Katarit hapi ambasadën e tij në Tiranë.

Marrëdhëniet konfirmohen dhe nga

realizimi i vizitave të niveleve të larta si dhe nënshkrimi i një sërë marrëveshesh të rëndësishme në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe institucionalizimit të bashkëpunimit.

EKONOMIA

Katari dikur ka qenë i njohur për tregtinë e perlave dhe ky aktivitet ishte burimi kryesor i të ardhura të vendit. Por, që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, me zbulimin e naftës, Katari filloi të zhvillohej, për t'u bërë një nga vendet më të rëndësishme prodhuese të naftës dhe gazit, në botë.

Edhe pse ka investime në rritje, në sektorë të ndryshëm nga energjia, megjithatë, nafta dhe gazi ende përbëjnë më shumë se gjysmën e prodhimit të përgjithshëm vendor.

Për shkak të rezervave të mëdha të naftës dhe gazit, të ardhurat për frymë në Katar konsiderohen nga më të lartat në botë.^[5]

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

1. <https://portal.www.gov.qa>
2. <https://www.lmaany.com/ar/dict/ar>
3. <https://mofa.gov.qa/en/qatar/history-of-qatar/historical-overview>
4. <https://www.diwan.gov.qa/about-qatar/history-of-qatar>
5. <https://portal.www.gov.qa/wps/portal/about-qatar?changeLanguage=ar>



TË DISTANCOHEMI NGA FRIKA, TË HAPIM DYERT E SHPRESËS..!

Të dashur dhe të shtrenjtë vëllezër e motra, besimtarë e bashkëqytetarë!

Kjo është e xhumaja e tretë, që ne nuk kemi mundësi të mblidhemi së bashku për kryerjen e namazit të kësaj dite të bekuar të xhumasë në xhamitë tona, për shkak të gjendjes në të cilën ndodhemi, ne dhe mbarë globi.

Pothuajse në çdo cep të botës, xhamitë janë mbyllur, ndonëse numri i tyre real sot, është mijëfishuar, a shumëfishuar pa masë, duke u kthyer krejt shtëpitë tona në xhami e faltore, ku së bashku me familjarët tanë po falemi e po lutemi, me shpresën e palëkundur në Zotin e gjithësisë se kjo gjendje do të kalojë e njerëzimi do ta kapërcejë pragun e kësaj lufte të re botërore.

“Jeta më ka mësuar ta bëj zemrën time qytet, shtëpitë e të cilit janë dashuria, rrugët e tij toleranca. Dhe, inxhinieria më e bukur në jetë është: NDËRTIMI I URAVE TË SHPRESËS MBI DETRA PESIMIZMI!”.

Ky është misioni ynë, ky është mesazhi i xhamisë, kjo është thirrja e Kur’anit, ky është udhëzimi që duam të përcjellim ditë pas dite, situatë pas situatë, vështirësi pas vështirësie, të mbështetur në Zotin e gjithësisë dhe të palëkundur në besimin e Tij!

Prej ditësh i jemi drejtuar besimtarëve për të shtuar lutjet dhe për të respektuar udhëzimet e institucioneve, që punojnë për të mirën e vendit dhe shoqërisë, duke respektuar në këtë mënyrë vlerën e jetës dhe të shëndetit, si dhe duke nxitur mirënjohjen dhe falënderimin ndaj Zotit, shoqëruar me lutje të vazhdueshme dhe kthim nga dera e Krijuesit tonë!

Në këtë kontekst, edhe mesazhi im i kësaj dite do të fokusohet tek mirënjohja dhe lutja, për të cilat kemi nevojë, sidomos në këtë realitet të ri, që po ndryshon rrënjësisht mënyrën e jetesës, mendimit dhe adhurimit në mesin tonë!

Është momenti, që ta falënderojmë All-llahun e Madhëruar për mirësitë e Tij të panumërta, me të cilat e ka begatuar jetën tonë, duke kujtuar lutjen e Hz. Muhammedit (a.s.): “... O Krijues i Madhëruar, mos e zhduk të mirën, me të cilën më ke begatuar”, si dhe ta

■ KY ËSHTË MISIONI YNË, KY ËSHTË MESAZHI I XHAMISË, KJO ËSHTË THIRRJA E KUR’ANIT, KY ËSHTË UDHËZIMI QË DUAM TË PËRCJELLIM DITË PAS DITE, SITUATË PAS SITUATË, VËSHTIRËSI PAS VËSHTIRËSIE, TË MBËSHTETUR NË ZOTIN E GJITHËSISË DHE TË PALËKUNDUR NË BESIMIN E TIJ!

TË GJITHË DUHET TË LUTEMI SOT, PËR TË PREKURIT NGA VIRUSI ME KURORË; ZOTI I DHASHTË DURIM E QETËSI PËR T’U PËRBALLUR NË FUSHËBETEJË, PA E HUMBUR SHPRESËN E BESIMIT, SEPSE ASGJË NUK DËMTON PA LEJEN ■ DHE VULLNETIN E ZOTIT! ■

falënderojmë Zotin tonë për ç’ka na ka dhënë, duke kujtuar porosinë e Resulull-llahut (a.s.) drejtuar Nanës tonë Aishe (r.a.): “O Aishe, respektoje praninë e mirësive të All-llahut, mos i largo ato, sepse s’para kthehen tek një popull, po u larguan prej tyre!”.

Ta falënderojmë All-llahun e Madhëruar për mirësinë e jetës, për natyrën e mrekullueshme, për ujin e pijshëm, për shëndetin, për familjen, për sigurinë, për ushqimin e përditshëm, për solidaritetin në mesin tonë, për bekimin e pranisë së prindërve si gurrë dashnie e paqeje në jetë, për fëmijët tanë, për rendin, për lirinë e besimit, për fjalën e lirë që ndërton dhe forcon urat e të mirës në shoqëri, për harmoninë komunitare, për pafundësinë e bekimeve, me të cilat është zbuluar jeta e jonë, edhe pse mund të jemi hutuar e mund të mos kemi ditur të falënderojmë Dhuruesin e tyre si duhet!

“Mirësia është e lidhur me falënderimin, ndërsa falënderimi është ngjitur pas shtimit e, të dy së bashku

qëndrojnë në një shinë të përbashkët! Nuk do të ndalet shtimi i begative nga All-llahu, përderisa të ndalet mirënjohja e falënderimi nga robi”, thoshte i urti Hz. Ali (r.a.)!

Prandaj ta falënderojmë pa ndërprerje Zotin tonë, sepse të mirat e Tij s’kanë fund dhe: “mundet që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju”.

Me lutjet tona, shoqëruar me mirënjohje dhe falënderim, i drejtohem Zotit tonë të begatohë dhe të ruajë shëndetin dhe përkushtimin e mjekëve dhe infermierëve tanë, që janë heronj të heshtur, shërbyes të sinqertë dhe bamirës fisnikë, sidomos në këto ditë!

Me humanizmin dhe vetëmohimin e tyre, ata qëndrojnë sot, në ballë të frikës, ankthit, lodhjes e mundit për më të mirën tonë, për më të mirën e njerëzimit, duke u bërë pjesë e dëshmisë së madhe shekullore: “Krejt njerëzit janë nevojtarë për All-llahun. Më i dashuri i tyre për Të, është më i dobishmi i tyre për krijesat e Tij!”.

Ne sot, nëpërmjet lutjeve tona për këta njerëz të mëdhenj, shprehim mirënjohjen më të thellë dhe përlujen me respekt para tyre dhe sakrificës së madhe me të cilën po dëshmojnë në këto ditë!

Të gjithë duhet të lutemi sot, për të prekurit nga virusi me kurorë; Zoti i dhashtë durim e qetësi për t’u përballur në fushëbetejë, pa e humbur shpresën e besimit, sepse asgjë nuk dëmton pa lejen dhe vullnetin e Zotit!

Poashtu lutemi për forcat e rendit, që janë shpërndarë gjithandej në rrugët e qytetit për udhëzimin dhe mbrojtjen e qytetarëve, për ndihmën e pakursyer, për insistimin e vazhdueshëm për respektimin e rregullave të reja, të cilat ndihmojnë në mbrojtjen e individit dhe shoqërisë, si dhe përkujdesjen në këtë situatë të krijuar pas shpalljes së pandemisë në rang global!

T’i drejtohem Zotit të gjithësisë me lutje për prijësit fetarë dhe punonjësit e mediave, që si dy vëllezër binjakë, punojnë në fronte të ndryshme, por më një qëllim të përbashkët: këshillimin e urtë, udhëzimin e drejtë, informimin e pjekur, fjalën e mirë dhe përhapjen e rrezeve të shpresës dhe të optimizmit,

në një gjendje, kur të gjithë kanë nevojë për një mbështetje dhe një qetësim të shpirtit, mendjes e zemrës!

T’i drejtohem Zotit duke kërkuar falje për gabimet e mëdha shkatërrimtare e mbytëse, që janë bërë në këtë vend, sidomos në këtë shekull, si dhe të lutemi që e nesërmja të jetë më e mirë dhe më e bardhë se ajo që kaloi!

Të dashur dhe të shtrenjtë,

Para shumë vitesh, së bashku me një grup studentësh vizituam një burrë të urtë, prej dijetarëve të Sirisë së dijes dhe qytetërimeve botërore. Ndonëse në gjendje të rënduar shëndetësore, fytyra e tij e qeshur ngjante me një diell vezullues. Shpresa dhe optimizmi i tij sa ishin befasues, aq dhe frymëzues!

Një natë, – foli me buzëqeshjen e tij të ngrohtë -, më zuri një dhembje e padurueshme. U ngrita me vrap dhe u nisa drejt dhomës tjetër për të kërkuar ndihmën e familjarëve. Për një moment e mbajta frymën dhe ndala hapin. Thashë me vete: E çfarë do të më bëjnë ata? Pse t’jua prish rehatinë e gjumit? A e kanë në dorë sëmundjen, dhembjen, vuajtjen time?! Dhe u ktheva. Mora abdes dhe u lidha në namaz. Në sexhde iu drejtova Krijuesit tim: All-llahumme, Ti je Zoti im, në dorën Tënde është shëndeti im, sëmundja ime, dhembja ime e shërimi im. Unë të dua Ty, të lutem ma largo këtë dhembje se nuk duroj më! ...

E solla këtë kujtim për të ftuar që secili prej nesh, përtej masave të marra, përtej ruajtjes dhe mbikqyrjes së situatës, të mos lërë pas dore lutjen, sepse Dera e Zotit, kur trokitet me zemër të dorëzuar, plot dashuri, pendim e shpresë, patjetër që do të hapet, sipas kodeve të thirrjes së shenjtë kur’anore: “E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra, le të më përgjigjen Mua dhe le të më besojnë, për të qenë drejt të udhëzuar”.

Të distancohem nga frika dhe të hapim dyert e shpresës, sepse një virus që lahet me ujë, që digjet në diell dhe që mund ta kemi kaluar shumica e jonë pa e vënë re, nuk mund të mbajë peng një botë të tërë, që e ka humbur fillin në duar të palara, që vazhdojnë ta mbajnë pis e ta mbysin në smogun e ligësisë, vendin e mëkëmbësve të Zotit!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

(Mesazhi i ditës së xhuma, më 27 mars 2020, në kushtet e pezullimit të tubimeve masive për shkak të pandemisë COVID-19)

A KA FORCË LUTJA, QË E VETME TË NDALOJË NJË PANDEMI SI VIRUSI KORONA? MADJE EDHE PROFETI MUHAMMED MENDON NDRYSHE!

Artikull i botuar në revistën amerikane "Newsweek", që flet për formën se si Muhammedi (a.s) ka këshilluar të sillemi në kohë pandemish.

Pandemia COVID-19 është duke i detyruar qeveritë dhe burimet e lajmeve që t’i ofrojnë popullatës botërore këshillat sa më të sakta dhe ndihmuese, sepse kjo sëmundje vërtetë po kaplon tërë globin. Kërkesat për mjekë dhe infermierë të profesionalizuar janë të larta, ashtu si edhe kërkesat për shkencëtarë që studiojnë format e përhapjes e pandemive dhe efektet e tyre.

Ekspertët, si imunologu Dr. Anthony Fauci dhe raportuesi për çështje mjekësore Dr. Sanjay Gupta thonë se higjiena e mirë dhe kuarantinimi, ose thënë ndryshe praktika e izolimit nga të tjerët me shpresën se do të mund të parandalohet përhapja e sëmundjeve ngjitesë, janë mjetet më efektive për ta kufizuar COVID -19.

Por, a e dini kush tjetër e ka sugjeruar higjienën e mirë dhe kuarantinimin gjatë një pandemie?

Muhammedi, Profeti i Islamit, para më shumë se 1300 vitesh.

Edhe pse ai, në asnjë formë nuk është një ekspert “tradicional” për sëmundje vdekjeprurëse, sidoqoftë Muhammedi ka dhënë këshilla shumë të shëndoshe për ta parandaluar dhe luftuar zhvillimin e sëmundjeve si COVID-19.

Muhammedi ka thënë: “Nëse do të dëgjoni se mortaja ka shpërthyer në një vend, mos hyni, mos shkoni atje, por nëse mortaja shpërthen në një vend, ndërsa ju jeni aty, mos e lëshoni atë vend!”

Ai gjithashtu ka thënë: “Ata që kanë sëmundje ngjitesë duhet të mbahen larg nga të shëndoshët”.

Muhammedi, gjithashtu i ka nxitur njerëzit fuqimisht që të ndjekin praktika higjienike që do t’i mbanin njerëzit të shëndoshë nga infektimi. Veni re thënietve –haditheve vijuese të Profetit Muhammed:

“Pastërtia është pjesë e besimit”

“Lani duart pasi të zgjoheni, sepse nuk e dini se kah kanë lëvizur duart tuaja derisa keni qenë duke fjetur!”

“Bereqeti i ushqimit fshihet në larjen e duarve para dhe pas ushqimit”

Po sikur dikë ta kaplojë sëmundja?

Çfarë këshille do t’u jepte Muhammedi njerëzve që po vuajnë nga dhimbjet?

Ai do t’i inkurajonte njerëzit që gjithmonë të kërkojnë trajtim mjekësor dhe shërim, duke thënë: “Shëroni veten tuaj me ilaçe! Sepse Zoti nuk ka krijuar asnjë sëmundje, e të mos ia këtë krijuar edhe ilaçin, përveç një sëmundjeje: pleqërisë.”

Mbase më e rëndësishmja është se ai dinte ta mbajë baraspeshën midis besimit dhe arsyes së shëndoshë. Në javët e fundit disa njerëz kanë shkuar aq larg me sugjerimet e tyre, saqë kanë sugjeruar se lutja do të ishte më e mirë për t’u mbrojtur sesa t’u përmbahesh rregullave bazë të distancimit social dhe kuarantinës. Si do të përgjigjej Profeti Muhammed idesë që lutja duhet të jetë arma e vetme, ose më e rëndësishme e shërimit?

Vini re këtij rrëfimi, të treguar nga shkencëtari persian i shekullit IX E’t-Tirmidhi që thotë: Një ditë Profeti Muhammed pa një beduin që po e linte devenë e tij pa lidhur. E pyeti beduinin: “Pse nuk e lidh devenë tënde?” Beduini u përgjigj: “I mbështetem Allahut”. Profeti i tha: “Lidhe njëherë devenë, pastaj mbështetu Allahut!”.

Muhammedi i nxiste njerëzit që të kërkojnë udhëzimin përmes fesë, por ai shpresonte gjithashtu se ata do t’i merrnin masat themelore parandaluese për të ruajtur stabilitetin, shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve.

Me fjalë të tjera: Ai shpresonte se njerëzit do ta përdorin arsyen e shëndoshë!

Dr. Craig Considine

Përktheu: Ensar Sinani

P.S.: Dr. Craig Considine është një shkencëtar, profesor dhe kontribuues për mediat, që punon në Departamentin e Sociologjisë në Universitetin e Rajsit (Rice University) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai është autor i veprës “Humaniteti (ana njerëzore) e Profetit Muhammed – Një pikëpamje krisitane” (Bule Dome Press, 2020) dhe i veprës “Islami në Amerikë: Eksplorim çështjesh” (ABC – CLIO, 2019) ndër të tjera.



Naim Driaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Në Kuranin fisnik, Allahu (xh.sh) i nxit besimtarët që të pendohen. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Çdo bir i Ademit është gabimtar, ndërsa me i miri prej tyre është ai i cili pendohet”.¹

- Këtë shkrim do ta ndaj në tri pjesë:
- Obligueshmëria e pendimit.
 - Vlera dhe rëndësia e pendimit.
 - Kushtet e pranimit të pendimit.

1. Çdo njeri e ka obligim personal (farzi ajn) për të kërkuar falje tek Allahu (xh.sh) për të gjitha gjynahet. Zoti (xh.sh) thotë: “Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë që të arrini shpëtimin”.²

Allahu (xh.sh) thotë: “O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë”.³

Hasan el-Basriu (rahimehullah) ka thënë: “Pendim i sinqertë do të thotë që njeriu të pendohet nga e kaluara e tij dhe të jetë i vendosur që të mos i kthehet kurrë më asaj gjendjeje”.

Kelbiu (rahimehullah) ka thënë: “Pendim i sinqertë është të kërkoshe falje me gjuhë, të pendohesh me zemër dhe me gjymtyrë”.

Seid ibn Musejebi (rahimehullah) ka thënë: “Pendimi i sinqertë është këshillimi i vetvetes”.⁴

- Pendimi i sinqertë është shkak për faljen e gjynaheve të bëra në të kaluarën. Pejgamberi (a.s) na ka treguar rastin e atij personit i cili kishte vrrarë njëqind vetë e pastaj u pendua tek Allahu i madhëruar dhe Ai ia pranoi pendimin.⁵

- Pendimi i sinqertë i shndërron veprat e këqija në vepra të mira. Allahu i Lartësuar thotë: “Ata që janë penduar, kanë besuar dhe kanë bërë vepra të

TË PENDUARIT ME SINQERITET

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Vërtet, Allahu e shtrin Dorën e Tij gjatë natës për të pranuar pendimin e gjynahqarëve të ditës dhe e shtrin Dorën e Tij gjatë ditës për të pranuar pendimin e gjynahqarëve të natës, kjo do të vazhdojë derisa të lindë dielli nga perëndimi”.

mira, Allahu ua shndërron të këqijat e tyre në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë”.⁶

Ebu Hurejre (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Unë i kërkoj falje Allahut dhe pendohem tek Ai më tepër se shtatëdhjetë herë në ditë”.⁷

Në një transmetim Pejgamberi (a.s) thotë: “Unë i kërkoj falje Allahut njëqind herë në ditë”.⁸ Nëse Pejgamberi (a.s) çdo ditë bënte kaq shumë teube edhe pse ai nuk kishte gjynahe, po ne atëherë sa herë në ditë duhet të bëjmë teube?

2. Vlera dhe rëndësia e pendimit.

Na mjaftojnë këto argumente që do të citojmë më poshtë për të treguar vlerën dhe rëndësinë e pendimit. Allahu i madhëruar në kuranin fisnik thotë: “Allahu i do ata që pendohen”.⁹ Në një ajet tjetër thuhet: “Allahu e pranon pendimin e robërve të Tij, i fal gjynahet dhe i di të gjitha çfarë punoni ju.”¹⁰

Allahu e mëshiron atë musliman që i kërkon falje atij. (Salihu i tha popullit të vet): “Përse nuk kërkon nga Allahu falje (të gjynaheve) që të mëshiroheni?!”.¹¹

Allahu gëzohet me pendimin e robërve të Tij. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu gëzohet për pendimin e robit të Tij më shumë se sa gëzohet njeriu në mes të shkretëtirës që gjen devenë e humbur, në të cilën ka pasur ushqimin e tij”.¹² “Ai që pendohet nga gjynahet është sikur ai që s’ka bërë gjynah”.¹³ Pra me pendim pastrohet shpirti dhe zemra.

3. Kushtet e pranimit të pendimit.

1. Sinqeriteti ndaj Allahut.

2. Largimi prej gjynaheve.

3. Keqardhje për gjynahet e bëra. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Keqardhja është pendim”.¹⁴

4. Vendosmëria për të mos u kthyer më në atë gjynah.

6. Kur’ani, El-Furkan: 70.

7. Transmeton Buhariu.

8. Transmeton Muslimi.

9. Kur’ani, El-Bekare: 222.

10. Kur’ani, Esh-Shura: 25.

11. Kur’ani, En-Nahl: 46.

12. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

13. Transmeton Ibn Maxheh.

14. Transmeton Imam Ahmedi dhe Hakimi.

5. Pendimi të bëhet në kohën që pranohet ai.

- Para se të vijë shpirti në gabzherr (në momentin e fundit të daljes së tij). Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu e pranon pendimin e robit të tij derisa nuk i ka ardhur ende fryma e fundit”.¹⁵

- Dhe para se të lindë dielli nga perëndimi.

Ebu Hurejre (r.a) transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kush pendohet para se të lind dielli nga perëndimi Allahu do t’ia pranojë pendimin”.¹⁶

Allahu (xh.sh) thotë: “Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: “Unë tani me të vërtetë po pendohem”.¹⁷ Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Vërtet, Allahu e shtrin Dorën e Tij gjatë natës për të pranuar pendimin e gjynahqarëve të ditës dhe e shtrin Dorën e Tij gjatë ditës për të pranuar pendimin e gjynahqarëve të natës, kjo do të vazhdojë derisa të lindë dielli nga perëndimi”.¹⁸

Këto janë 5 kushtet e pendimit nëse gjynahu është mes robit dhe Zotit por nëse gjynahu është mes njerëzve atëherë i shtohet edhe një kusht tjetër.

6. Kthimi i hakut (të drejtës) dhe kërkimi i faljes, nëse gabimi është bërë ndaj ndonjë njeriu. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush i ka bërë vëllait të tij ndonjë padrejtësi, qoftë ajo në pasuri apo në nderë, le t’i kërkojë falje (le t’ia kthejë) para se të vijë dita në të cilën nuk ka dinar e as dërrhem, por ka (vepra) të mira ose të këqija”.¹⁹ Është obligim për muslimanin, që t’ia kthejë hakun dhe t’i kërkojë falje atij që i ka bërë padrejtësi, para se të vijë dita e vështirë, në të cilën ndërrohen gjërat e mira me të këqija. Në ditën në të cilën nuk ka mundësi besimtari të shtojë një të mirë në të mirat e tij, e as të pakësojë një të keqe nga të këqijat e tij.

15. Transmeton Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh.

16. Transmeton Muslimi.

17. Kur’ani, En-Nisa: 18.

18. Transmeton Muslimi.

19. Transmeton Buhariu.

PROMOVOHET LIBRI: “DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST”, I AUTORIT DR. MUSTAFA MAHMUD



Pasditen e së xhumasë, më 6 mars 2020, në ambientet e Grand Hotel Europa, Myftinia Shkodër organizoi promovimin e librit “Dialog me mikun tim ateist”.

Aktivitetin e hapi teologu Ervil Kuçi, i cili pasi i uroi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre bëri një prezantim të shkurtër të librit “Dialog me mikun tim ateist”, i autorit Dr. Mustafa Mahmud, sjellë në gjuhën shqipe nga teologu Lavdrim Hamja.

Më pas e mori fjalën Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili pasi falënderoi përkthyesin për sjelljen e këtij libri me vlerë në gjuhën shqipe, tha: “Libri i ri që promovojmë sot, “Dialog me mikun tim ateist”, shkruar nga studiuesi dhe intelektual i shquar egjiptian, Dr. Mustafa Mahmud, sjellë në shqip nga thirrësi islam Lavdrim Hamja, është padyshim një vlerë e shtuar për librotekat tona.”

Imam Sytari, ndër të tjera tha: “Është një libër që lexohet me kujdes, por që vlen për secilin prej nesh, sidomos në kohëra si këto, kur thuajse nga çdo drejtim dëgjojmë sulme të pandërprera ndaj Islamit dhe muslimanëve.

Aq sa janë paradoksale ato që lexojmë e dëgjojmë, aq është i domosdoshëm për t’u qarkulluar në mesin e lexuesve ky libër, që gjithësesi nuk është as fillimi, as fundi i trajtesave të të pjekura e plot urtësi të tematikave të këtij niveli, që shpesh kanë ngacmuar botën, lidhur me Islamin.”

Më pas, teologu Artur Tagani, kandidat për Doktor Shkencash në fushën e Sociologjisë dhe Filozofisë, trajtoi me shumë kompetencë temën “Ateizmi si pasojë”, duke sjellë shembuj dhe argumente bindëse rreth përhapjes

së ateizmit në botë, por edhe në vendin tonë.

Ndërsa teologu Arben Halluni foli rreth librit, duke u ndalur te rëndësia e të kuptuarit drejtë të koncepteve islame, veçanërisht të kadasë dhe kaderit, dy terma shumë të rëndësishme të fesë islame, që kanë të bëjnë me përcaktimit e Zotit.

Në fund e mori fjalën edhe përkthyesi i librit, teologu Lavdrim Hamja, i cili foli për jetën e autorit të librit, Dr. Mustafa Mahmud dhe solli disa thënie të tij, ku ndër të tjera përmendi: “Asnjëherë nuk kam qenë njeri i fesë (klerik), por artist që kam hyrë në prehrin e fesë prej derës së mirësisë hyjnore dhe prej derës së dashurisë e bindjes dhe jo nga dera e Ez’herit.

Gjykimi im ka qenë gjykimi i poetit, i cili e deshi Allahun dhe shkroi për Të vargje dhe ndërtoi një xhami. Por, ai gjithmonë mbeti artisti që në origjinë dhe krijim. Ky artist, pasuria e të cilit është imagjinata dhe ndjenjat.

Arti ka qenë gjithmonë dobësia dhe fuqia ime. Si çdo artist, edhe për mua bukuria ka qenë frymëzim.

Kam qenë njeri gabimtar dhe për këtë arsye asnjëherë nuk kam pretenduar të jem i pagabueshëm.”

Aktiviteti u përfundua edhe nga imami i xhamisë së Rusit, H. Fejzi Zaganjori, i cili theksoi se ky aktivitet në kuadër të 30 vjetorit të lirisë së besimit, merr një vlerë edhe më të madhe, kur sheh se teologët dhe thirrësit islamë shkrojnë të kësaj kohe, po punojnë me përkushtim në rrugën e përhapjes së dritës së besimit.

Në përfundim të këtij promovimi, për të pranishmit u bë edhe shpërndarja e librit: “Dialog me mikun tim ateist”.

SHËNDETI DHE MJEKËSIA NE TRADITËN ISLAME

Prof. Fazlur Rahman

Një nga pikat që trajton autori është edhe “Etika e Mjekësisë”, çështje që ka zënë kapituj të tërë të veprave të vetë mjekëve ndër shekuj.

Doktori -shprehet er-Ruhaviu (shek. 10), nuk duhet ta konsiderojë si një biznes këtë profesion, pasi kjo gjë do të bëhet pengesë për zhvillimin normal të këtij shërbimi. Pagesa për doktorin duhet t’i shërbejë të bëjë një jetë normale familjare. Ndërkohë, er-Ruhaviu i bën apel shtresës së pasur të shoqërisë, që të shpërblejnë me bujari doktorët, në mënyrë që mjekët të mund të bëjnë shërbime falas për të varfërit.



Ndërsa, mjeku i famshëm Ebu Bekir er-Razi (shek. 9), thekson etikën dhe përgjegjësinë që duhet t’i përmbahen si mjeku ashtu edhe pacienti: i sëmuri duhet të ndjekë me rigorozitet këshillat e mjekut, ta respektojë dhe ta konsiderojë atë pors i një mik. Ndërsa mjeku duhet të jetë njeri i kulturuar, i edukuar, të ketë durim dhe duhet të krijojë besim tek pacienti. Mbi të gjitha, mjeku nuk duhet të mjaftohet me librat klasikë që ka lexuar, ai gjithnjë duhet të ketë përgjegjësinë e zhvillimit të vetes. Të bëjë një jetë me regjim normal, larg dëfrimeve të shfrenuara dhe kohës së konsumuar kot, pasi humb energjinë e nevojshme për shërbimin shëndetësor. - (A.T)

LIGJËRATË MBI VLERËN E TRE MUAJVE TË MIRË NË BËRDICËN E MESME

Ditën e hënë, më 9 mars 2020, pas namazit të akshamit, në xhaminë e fshatit Bërdicë e Mesme, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet, në kuadër të Tre Muajve të Mirë.

Pas faljes së namazit të akshamit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti një fjalë para të pranishëmve, ku vuri theksin te pastrimi i nijeteve, sidomos në këtë periudhë, në prag të Muajit të Begatë të Ramazanit.

Ligjëratën kryesore e mbajti imami i xhamisë “Ebu Bekër”, thirrësi islam, Ildmir Plaku.



Në këshillat e tij, imami i nderuar u ndal tek shfrytëzimi i kësaj periudhe

të begatë tremujore, ku besimtarët muslimanë në mbarë botën përgatiten me pendim e lutje, me agjërime e bamirësi, për të prituri Muajin Ramazan.

Imami i nderuar theksoi se muaji Rexheb dhe ai që e pason, Muaji Shaban, janë një periudhë e begatë, në të cilën shpërndahet mëshira e All-llahut dhe besimtarët janë të ftuar të shtojnë përkushtimin dhe adhurimet e tyre vullnetare, me qëllim afrimin me Zotin dhe dëshmimin e mrekullive të besimit në jetën e përditshme.

MYFTIU: “ISLAMI UDHËZON DREJT PASTËRTISË DHE JETËS SË SHËNDETSHME!”

Ditën e martë, më 10 mars 2020, pas namazit të akshamit në xhaminë e Tophanës, u zhvillua një bashkëbisedim rreth temës së pastërtisë dhe etikës së të ushqyerit dhe pijes në Islam.

Fillimisht ishte imami i xhamisë, teologu Ferid Rrilla, i cili lexoi dhe komentoi disa hadithe nga libri “Rijadus-Salihine”, që lidhen me temën.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, u ndal tek shpjegimi i disa prej teksteve kur’anore dhe haditheve të shumta, që lidhen me pastërtinë, nxitjen e saj dhe faktin madhor, se Islami është fë e pastërtisë në çdo drejtim.

“Resulull-llahu (a.s.) i mësoi sahabët e tij dhe muslimanët deri në kijamet se pastërtia është gjysma e besimit.

Ai i mësoi ata të pastrohen pesë herë në ditë, duke nisur me larjen e duarve, shpërlarjen e gojës, gargarat me ujë,



pastrimin e kanaleve të hundës poashtu, larjen e fytyrës, krahëve, fërkimin me dorë të lagur të kokës e larjen e këmbëve!

I obligoi për pastrimin e gojës dhe dhëmbëve poashtu. I mësoi gusulin, larjen e përgjithshme, që nuk lidhet me ditë e natë.

I mësoi larjen e duarve para ushqimit, pas ushqimit, ngrënien me kafshata të vogla, të ushqyerit dhe pijen në pozicion ulur dhe me tre hurtha.

I mësoi synetimin e djemve që në ditën e shtatë, pas lindjes, heqjen e flokëve të parë. Subhanallah, veç pastërti.

Na janë ndaluar ushqimet dhe pijet e dëmshme, si: derri, kafshët grabitqare, etj., sikurse jemi urdhëruar të distancohemi nga çdo pije alkoolike!

Sepse në Islam, ne jemi urdhëruar dhe brumosur të jetojmë pastër dhe shëndetshëm!” – tha ndër të tjera Myftiu.

LIGJËRATA E NATËS SË ISRASË DHE MIRAXHIT

Ditën e xhuma, më 20 mars 2020, në kuadër të aktiviteteve dhe ligjëratave të Tre Muajve të Mirë, si dhe në kushtet e imponimit të qarkullimit të kufizuar dhe anulimit të tubimeve fetare nëpër xhami për shkak të pandemisë së re që ka pllakuar botën, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare, ku nëpërmjet faqes zyrtare në fb, teologu Lavdrim Hamja imam i xhamisë së Dy Vajzave, mbajti një ligjëratë me dobi me rastin e Natës së Madhe të Israsë dhe Miraxhit.

Imami i nderuar shpjegoi domethënien dhe peshën historike të kësaj ndodhie shumëdimensionale, që



kulmoi me obligimin e pesë namazeve ditore, si ajka e adhurimeve në Islam.

Ai shpjegoi se Israja dhe Miraxhi ishte një çlirim për të Dërguarin e All-llahut dhe muslimanët, si dhe një moment, ku të gjithë peygamberët u mblodhën së bashku, për t’u dëshmuar se Thirrja e Zotit është Një dhe se, udhëzimet e fesë kanë për qëllim edhe afrimin e njeriut me vëllanë e tij njeri.

“E përkujtojmë këtë mrekulli për mësimet e saj të mëdha, për mesazhet që na përcjell! – theksoi ligjëruesi i nderuar.

LIGJËRATAT DITORE, UDHËZIM DHE KËSHILLA ME DOBI PËR BESIMTARËT

Në kushtet e pezullimit të tubimeve të ndryshme fetare, në kushtet e përhapjes së pandemisë së re në rrafsh botëror, Myftinia Shkodër ka përgatitur një plan të ngjeshur me ligjëratat dhe mesazhet e përditshme fetare, nëpërmjet të cilave, imamët e nderuar i drejtohen besimtarëve për durim dhe shpresë, për lutje dhe ruajtjen e frymës së besimit të palëkundur në mëshirën e All-llahut të Madhëruar.

Çdo ditë, në orën 10.00, besimtarët kanë mundësi të ndjekin drejtpërdrejt online nëpërmjet faqes zyrtare në fb, mesazhin e ditës, që jep Myftinia Shkodër nëpërmjet imamëve të saj, me qëllim që të ruhet lidhja e besimtarëve me imamët e tyre dhe përfitimit nga këshillat dhe urtësitë e fesë islame, edhe në kushtet e situatës që kalojmë.

PROGRAMI I LIGJËRATAVE ONLINE PËR PERIUDHËN 23 - 31 MARS 2020		
DATA	LIGJËRUESI	TEMA
E Hënë 23.3.2020	H. Durim Kasemi	Mbështetja në Krijuesin e gjithësisë
E Martë 24.3.2020	H. Adem Pizga	Mëshira e Zotit për krijesat e Tij
E Mërkurë 25.3.2020	H. Altin Nikshiqi	Vlerat dhe dobitë e namazit
E Enjte 26.3.2020	H. Naim Drijaj	Të penduarit me sineritet
E Xhuma 27.3.2020	Imam Muhamed B. Sytari	Ligjëratat e ditës së xhuma
E Shtunë 28.3.2020	H. Gilman Kazazi	Angazhimi me Kur'an
E Diel 29.3.2020	H. Fejzi Zaganjori	Solidariteti në Islam
E Hënë 30.3.2020	H. Ildmir Plaku	Duaja në jetën e muslimanit
E Martë 31.3.2020	H. Ruzhdi Plangaj	Namazi i natës dhe dobitë e tij

Programi i ligjëratave online për periudhën 23-31 mars 2020, ka një larmi tematikash, që trajtohen nga imamët tanë, duke udhëzuar besimtarët drejt ruajtjes së ekuilibrave të fesë në kushtet e reja, si dhe shfrytëzimin e kohës për

të përsosur adhurimet ditore.

Gjatë kësaj periudhe kanë ligjëruar dhe do të japin këshillat e tyre, imamët e nderuar: H. Durim Kasemi, H. Adem Pizga, H. Altin Nikshiqi, H. Naim Drijaj, H. Gilman Kazazi, H. Fejzi Zaganjori, H. Ildmir Plaku dhe H. Ruzhdi Plangaj.

Programi i ligjëratave online do të vazhdojë edhe gjatë muajit prill,

sipas programit të përcaktuar nga Myftinia Shkodër, që do të publikohet gjatë ditëve në vijim.

Ligjëratat filmohen dhe publikohen edhe në faqen zyrtare të Myftinisë Shkodër në youtube (MYFTINIA SHKODER1990).

MYFTIU: “THIRRJA E BESIMIT ËSHTË QË NJERIU TË MOS E HUMBË SHPRESËN!”



Ditën e martë, më 24 mars 2020, në një lidhje të drejtpërdrejt në Tv1 Channel, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed B. Sytari dha mesazhet e tij drejtuar qytetarëve, ku u shpreh se realitetet e sotme na imponojnë të meditojmë e të reflektojmë rreth hakut të Zotit, mirësive dhe bekimeve me të cilat është zbuluar jeta e njeriut.

Myftiu theksoi se përtej faktit se dyert e xhamive janë të mbyllura për shkak të sigurisë dhe mbrojtjes, çdo shtëpi e jona duhet kthyer në xhami, ku pjestarët e familjes të kryejnë faljet ditore, lutjet e adhurimet e ndryshme. Sepse, namazi në shtëpi në këto ditë ka një shpërblim të veçantë tek Krijuesi i gjithësisë.

Ai bëri thirrje që në këto ditë të vështira për njerëzimin, njerëzit të mos e humbasin shpresën dhe besimin në Zot,

sepse Ai që na ka krijuar nga asgjëja dhe na ka rrethuar me dashuri e mëshirë, nuk do na braktisë në këto momente, kur të gjithë lutemi e shpresojmë në mëshirën e Tij.

Myftiu përmendi edhe ndihmën ndaj nevojtarëve, ku theksoi se të gjithë jemi të ftuar të ndihmojmë e të përkrahim skamnorët, jetimët e nevojtarët e shumtë. Në këtë kontekst, ai theksoi se edhe Myftinia Shkodër në bashkëpunim me institucionet bamirëse, shoqata e fondacione, po bën sa ka mundësi për të ndihmuar familje në nevojë në zonën e Shkodrës.

Myftiu iu drejtua qytetarëve me lutjen që mos të dëshpërohen, të mbështeten tek Zoti i tyre, të kërkojnë prej Tij me zemër dhe të luten në shtëpitë e tyre për më të mirën, për vete dhe për mbarë njerëzimin.

“SA BLEJNË NJË MASKË TË BLEJNË NJË BUKË”, ARTIZANIA SHKODRANË DHURON MASKA FALAS...

Në këto ditë të vështira ku të gjithë ne vuajmë nga pandemia e një virusi që ka bllokuar jetën tonë, shpesh herë ju kemi folur për raste të tregtarëve abuzivë, të cilët kanë rritur çmimet e produkteve që tregtojnë. Ndërkohë rasti që do ju sërëvim sot është rasti i një zonje që ka zgjedhur të ndihmojë sado pak në këtë situatë.

Profesionin e saj si rrobaqepëse, ka zgjedhur që në këto ditë ta shfrytëzojë për të realizuar disa maska prej pambuku të cilat i ka vetë sterilizuar edhe i dhuron për njerëzit, të cilët e kanë domosdoshmëri përdorimin e tyre.

Ardiana na tregon se shkasin e kësaj nisme e mori nga ata njerëz, që kanë rritur çmimet e produkteve të tilla, të cilat në këto ditë duhen më shumë se asnjëherë tjetër. Këto maska mund të lahen me temperaturë të lartë edhe me pas të hekurosen e të ripërdoren përsëri.

Më shume se një ndihmë e madhe, ky është një shembull i mirë për t’u ndjekur nga të gjithë. - (www.tv1-channel.tv)



JA SI PO NDIHMOJNË NË LUFTËN ME KORONAVIRUS, SHQIPTARËT E MREKULLUESHËM TË SHBA!

Nju-Jorku vazhdon të paraqesë rrezikun më të lartë të të infektuarve nga Covid-19. Në mbarë Amerikën, bizneset dhe çdo gjë tjetër është e mbyllur. E në këtë sfidë për jetën, shqiptarët më shumë se kurrë po i japin shpresë, mbështetje dhe bujarë familjeve, qytetarëve amerikanë, spitaleve, komisiariateve të policisë, departamenteve të zjarrfikësve, infermierëve, mjekëve, të moshuarave e çdo individi tjetër që në pamundësi shqiptarët siç u ka hije me bujarinë e zemrën e madhe po ofrojnë ushqim falas.



Nehat Kërkuti, [Nik] një ndër biznesmenët e fuqishëm e të njohur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pronari i shumë restoranteve në Manhattan Nju-Jork, si "Paul's on Times Square" "Uncle Paul Pizza" etj, përgjatë këtyre ditëve të vështira, po qëndron njësoj me heronjtë e tjerë në shërbim të njerëzve në vijën e parë të luftës betejës së këtij virusi duke shpërndarë ushqim falas.

Z. Nehat, së bashku me familjen dhe tre djemtë e tij, po bën një vepër të jashtëzakonshme. Në dispozicion 24 orë ai ka hapur dyert e të gjitha restoranteve të tij ku nëpërmjet shërbimit take out dhe delivery, të gjithë ata që telefonojnë për të porositur ushqim nga shtëpitë, e kudo gjenden, z. Kërkuti po ofron çdo porosi të ushqimeve falas. Gjatë këtyre javësh, ai i është dedikuar këtij misioni fisnik, si një shqiptar me zemër të madhe e bujare. Nik ka tërhequr vëmendjen edhe të medieive amerikane, si televizioni më i fuqishëm i informacionit 'Fox News' në një lidhje të drejtpërdrejtë me gazetaren e njohur Dana Perino, ka transmetuar live nga një prej restoranteve të tij, punën e mirë të z. Nehat. Gazetarja e ka komentuar si një gjest i mrekullueshëm human dhe e ka falënderuar me mirënjohje në

emër të qytetarëve. Spitalet kryesore të Manhattan po furnizohen me ushqime të përgatitura nga restorantet e Nehat Kërkutit, për gjithë të palodhurit, bluzat e bardha, mjekë, infermierë e gjithë personelit të spitaleve të ndryshme i është siguruar nga z. Kërkuti shpërndarja e ushqimeve falas derisa kjo situatë të mbarojë. Ai i emocionuar ka thënë për dritare.net se e ndjen me zemër t'i qëndrojnë pranë qytetarëve amerikanë në këto ditë të mjerueshme.

"Do të vazhdoj t'u shërbej deri në momentin e fundit, të gjithë atyre që po vënë jetën e tyre në rrezik për të shpëtuar jetën e njerëzve nga ky virus.", thotë Kërkuti.

Ndërkohë, me humanizmin e tij, po i shërben me ushqim e pije edhe zjarrfikësve të departamentit kryesor të zjarreve në Nju-Jork, gjithashtu dhe policisë së Nju-Jorkut, oficerëve, agjentëve dhe personelit të departamentit kryesor policor në Manhattan.

Shqiptarët janë solidarizuar në emër të mirësisë ndaj njeri-tjetrit pa dallim kombësie, duke treguar shembullin më të mirë për amerikanët. Gjatë gjithë kohës jam në kontakt me miqtë e mi që kanë zgjedhur të jenë në shërbim të situatës.

Kam kontaktuar për dritare.net me **Jetmir Agën**, një djalë i ri shkollor i cili jeton dhe vepron në Nju-Jork si menaxher i përgjithshëm i një prej restoranteve më të mira në Nju-Jork, dhe në gjithë Amerikën "Mastro's Steakhouse".

Ai thotë se restoranti është i hapur vetëm për t'i shërbyer qytetarëve dhe të gjithë institucioneve në gatishmëri. Është një krenari e madhe teksa sheh shqiptarët në këtë mision të përbashkët e djem të rinj, si Jetmiri i cili është një shembull dhe krenari për komunitetin shqiptaro-amerikan.

Burim Zuta, një tjetër personalitet dhe humanist i madh i komunitetit shqiptar, një biznesmen i suksesshëm, njihet për veprimtaritë e tij të ndryshme ndër vite në Nju-Xhersi dhe në Nju-Jork. Ai vullnetarisht po ndihmon të prekurit nga ky virus jo vetëm me ushqime falas nga restorantet e tij, por ka bërë të mundur shpërndarjen e një numri të madh maskash, te qytetarët e moshave të vjetra që e kanë të pamundur të furnizohen me ushqime, z. Zuta, po ofron shërbimin falas të take out, dhe

delivery, për të gjithë qytetarët, mjekët, zjarrfikësit, policët të shtetit të Nju-Jorkut dhe Nju-Xhersit.

"Miku i mirë njihet në ditë të vështirë." - Kështu shprehet Burimi teksa krenohet për këtë iniciativë personale ku ka angazhuar dhe djalin e tij 17-vjeçar **Durim Zuta**, duke i trashëguar traditën e bukur të bamirësisë së familjes së tij edhe fëmijëve.

Ai tregon se ky virtut bujarie e ka prejardhjen që nga të parët e tij. Ndër të tjera, Zuta tregon programin e tij për javën në vijim ku do t'u shërbejë me



ushqim falas 2 spitaleve më të njohura "Hackensack Hospital" dhe "Wayne Hospital" ndërkohë është në biseda për të bashkëpunuar po falas edhe për një tjetër spital të madh në Manhattan, "Port Authority Police" dhe NYPD.

"Ashtu sikurse punonjësit e rendit dhe shëndetësisë po rrezikojnë jetën e tyre për të na shërbyer ne, ashtu dëshiroj t'ua kthej me mbështetje e të jem me ta deri sa kjo krizë botërore të kalojë e shpresoj të jetë sa më e shpejtë zhdukja e virusit, por premtoj se sa të kem mundësi do t'u qëndrojnë afër.", thotë Burimi

Burim Zuta, ka ndihmuar jo vetëm me ushqime falas, por edhe financiarisht ka kontribuar për të prekurit.

Edi Drishti, shqiptari i lindur në Amerikë, komandant i Komisarariatit të Policisë Hoboken/ Nju-Xhersi, së bashku me oficerin e njohur të policisë amerikane, shqiptarin, Elton Shametaj, po bëjnë një punë të shkëlqyer, në gatishmëri të plotë ndaj rendit, dy heronj shqiptarë që rrezikojnë jetën e tyre në vijën e parë të kësaj beteje për t'i shërbyer qytetarëve.

Kozeta Turishta, USA

Marrë nga: (www.dritare.net)

PO TË ISHTE YT BIR, ... DO THOJE TË VËRTETËN!



Po të ishte yt bir kishe me e mbushë detin me anije të çdo lloj flamuri.

Kishe dashtë që të gjithë bashkë me miliona me ndërtu urën që ai me shpëtu...

Po të ishte yt bir, do ishe hedhë në det,

e kishe vra peshkatarin që nuk ta dha barkën,

Kishe piskatë me kërk ndihmë, kishe me trokit dyerve të qeverive...

Por rri i qetë, ne shtëpinë tende te ngrohte,

nuk asht yt bir, nuk asht yt bir.

Mundesh me fjet i qetë

E mbi te gjitha i sigurt.

Nuk asht yt bir.

Asht thjesht fëmija i humanizmit të humbur,

i humanizmit të ndytë, që nuk bëzan.

Nuk asht yt bir, nuk asht yt bir.

Flej i qetë,

nuk asht i yti.

Ende jo...

(Sergio GUTTILLA)

Janë këto vargje të poetit që u përhapën para ca vitesh kur u dukën pamjet e fëmijëve sirianë të mbytur në breg të detit. Jashtëzakonisht prekëse. Tejet të sakta e therëse për shumicën e njerëzve. Me përjashtim të atyre që nuk u dhimbën fëmijët e as refugjatët, por idhujt e tyre politikë-mitikë.

Edhe përpara atyre pamjeve të tmerrshme, jashtëzakonisht prekëse nuk guxojnë ta thonë të vërtetën. Nuk guxojnë e madje as nuk duan ta thonë se burimi i krizës siriane asht regjimi

VRASJA E PASHPIRT E PAFAJËSISË FËMIJËRORE VAZHDON!

Edhe sikur një maceje Perëndimore - e jo më një familjeje të tërë - t'i kishte ndodhur ky tmerr rrëqethës që shihni në fotografinë që e shoqëron këtë postim, do ulërinin mediat e botës, ku nuk do mungonte as kuja e mediave tona, si dhe ajo e shqiptarëve të famshëm, me orientim të padiskutueshëm properëndimor!

Por, kur 'mikpritja' Perëndimore dhe e BE-së është si kjo në kufirin grek, shumica e 'zëdhënësve' të botës së 'civilizuar' shtiren se nuk kanë dëgjuar gjë.

Ja pra, kështu e dëgjon dhembjen e tjetrit veshi i atyre që edhe humanizmin e kanë ngrit në rrafshin e 'biznesit' fitimprurës, duke e përdorur atë vetëm sa për të qenë i pëlqyer nga më i forti, më i pasuri dhe më i pushtetshmi. Dhe që ndihmuan që kjo botë të bëhet pyllnajë ku nuk dihet se cilat 'bisha' janë më gjakpirëse se tjerat.

Dhe 'Pranverë arabe', e paralajmëruar si 'puhizë' që popujve

të atjeshëm do u sillte demokraci dhe vlera perëndimore, përfundoi si varrezë masive e pafajësisë fëmijërore dhe e fatkeqësve të pambrojtur që naivisht besuan se kjo botë nuk do lejojë që ata të përfundonin nën rrënojat e shtëpive të tyre. Dhe kështu pra, gërmadhat e qyteteve që ishin begati kulturore e njerëzimit, sot pasqyrojnë fytyrën e shëmtuar të botës së sotme, të cilën e sundojnë mjeshtrit e luftës.

E në ndërkohë, vrasja e pashpirt e pafajësisë fëmijërore vazhdon, gjë që dëshmon se kjo botë është kopsht dhe parajsë e të 'fortëve', e ujitur me gjakun dhe me fatkeqësinë e popujve të 'prapambetur'.

Dhe po kjo botë e shurdhër dhe e pandjeshme ndaj tragjedisë dhe dhembjes së popujve të 'pacivilizuar', gjithmonë është shtirur se i mungojnë pamje të reja rrëqethëse të fëmijëve të vrarë e të helmuar, që ta kuptojë se ky planet është ndarë në dy pjesë: në pjesën ku jetojnë popujt 'human' e të 'civilizuar' që e festojnë jetën dhe, në pjesën tjetër, që është bërë varrezë masive e fatit të popujve të pafat."

Kim Mehmeti



kriminal i dinastisë kriminale të asadëve, pushtues të vërtetë të një vendi që kurrë nuk i deshi dhe kurrë nuk e deshën.

Asht karrigia e pushtetit ma e shtrenjtë në historinë njerëzimit në dekadat e fundit. Ruajtja e karriges së pushtetit të dinastisë kriminale të asadëve, i ka kushtuar Sirisë mijëra vjet trashëgimi kulturore të humbur

përgjithmonë, miliona të vrarë, dhjetëra miliona refugjatë, miliona jetima. Kurse botës, i ka kushtuar trilionat e dem ekonomik, e pafund dem moral e emocional.

E ti, vazhdon të mos e thuash të vërtetën...!

Ardian Muhaj



*"Nuk do të jesh praktikant i fesë,
veçse duke qenë **I DITUR,**
sepse **ALL-LLAHU**
nuk adhurohet me injorancë!"*



Dr. Mustafa Mahmud (1921-2009)

 Myftinia Shkodër

www.myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org